AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
"FIZIOTERAPI"

i

UNIVERSITETI KATOLIK

"ZOJA E KESHILLIT TE MIRE"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1.As.Prof. IRENA KOLA

2. Dr. ENKELEDA SINAJ

Tetor/2021

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**
**Për Programin e studimit Bsc në Fizioterapi të ofruar nga Institucioni Arsimit të Lartë Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Fakulteti i Mjekësisë |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Fizioterapi" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM Nr. 567 datë 27.08.2004 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | UMAS Nr.214, datë 14.11.2018 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | UMAS Nr.341, datë 16.09.2015 |
| 8 | Cikli i studimit: | Bachelor |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 Vite |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Italisht |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | Universitetin Tor Vergata, Romë |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | Laura in Fisioterapia/ Bachelor in Fisioterapia |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 33 PAE/31 PAK v.a. 2020-2021<br>33 PAE/28 PAK v.a. 2019-2020<br>31 PAE/30 PAK v.a. 2018-2019 |
| 18 | Numri i studentëve: | 50 Studentë v.a. 2020-2021<br>75 Studentë v.a. 2019-2020<br>100 Studentë v.a. 2018-2019 |
| 19 | Komente / të tjera: | |

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit Bachelor në "Fizioterapi", në Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" është hapur si program i ciklit të partë të studimit me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 567 datë 27.08.2004. Programi është akredituar për herë të parë në vitin 2007, me Urdhrin Nr. 375 datë 18.10.2007 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Shqipërisë dhe me Vendimin nr. 41 datë 05.05.2015 fitoi akreditimin periodik nga Këshilli I Akdreditimit të Arsimit të Larte. Në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë dhe Kirurgjisë të Universitetit të Romës "Tor Vergata", sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2005, në përfundim të studimeve, lëshohet një *diplomë e përbashkët* nga Universiteti "Tor Vergata" në Romë dhe ai i Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë.

Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi", është organizuar në lëndë e module dhe vlerësuar në kredite, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republiken e Shqipërisë dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, me kohëzgjatje tre vite akademike dhe gjithsej 180 kredite. Personeli akademik është i përbërë nga lektorë shqiptarë dhe italian në bashkëpunim me Universitetine Romës "Tor Vergata". Programi i studimit ofrohet ne gjuhen italiane dhe ju drejtohet kandidatëve shqiptarë dhe të huaj që zotërojne diplomen e shkollës së mesëme.

Ky program studimit është hartuar për të siguruar formim të specializuar, në gjendje që i diplomuari të veprojë me aftësi dhe autonomi profesionale në fushën e rehabilitimit si dhe të siguroj profesionistë të rinj të standardit europian, në mënyrë që të mbështesin zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë shqiptare dhe përparimin e arsimit dhe kërkimit universitar në nivel kombëtar dhe rajonal.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në "Fizioterapi" në Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", u përpilua nga dy profesorë me përvojë dhe ekspertë të fushës: As.Prof Irena Kola dhe Dr. Enkeleda Sinaj. Gjatë gjithe procedures, grupi i eksperteve të jashtëm u asistua nga perfaquesi i ASCAL, Msc.Muhamed Prezja.
Ekspertët e vlersimit bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga UKZKM dhe ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërsië", në VKM Nr.41 datë 24.01.2018 të ndryshuar, në Udhëzimin Nr. 1 datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", VKM Nr. 531, kane kryer vlerësimin e programit te studimit Bachelor në "Fizioterapi".

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi Universitetin në daten 9 dhe 10 Qershor 2021 dhe u takua me përfaqësues për të kuptuar dhe pyetur më tej anëtarët kryesorë të stafit në lidhje me Vlerësimin e Brendshëm të paraqitur nga UKZKM.
Procesi i vlerësimit filloi me një takim të drejtuesve të programit, Dekanit, Kordinatores dhe Sekretares të programit te studimit ne "Fizioterapi", duke vazhduar me pas me intervista drejtuar te gjithe antareve që hartuan Vleresimin e Brendshëm.
Takimet pasuese ishin me departamentin e Burimeve Njerëzore, te Projekteve, Orientimit të Karrierës, Marrëdhëniet e Jashtme, Bilboteken, student të programit te studimit në "Fizioterapi" si dhe vizitën në Qendrën Spitalore Universitare "Zoja e Këshillit të Mirë".
Gjatë këtyre takimeve u diskutua mbi procesin mesimor dhe mesimdhënien online, kualifikimet dhe rekrutimi i stafit akademik, praktikat mesimore me institucionet e akredituara, marreveshjet e bashkpunimit me universitetet italiane, mundësitë e punësimit etj.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është konsultuar me njëri-tjetrin për të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e paraqitura në këtë raport dhe kanë rënë dakord së bashku për vlerësimin e vertetë e të sinqert të standardeve.

**SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi", me Vendim nr.341, datë 16.09.2015 ka perfituar akreditimin me vlefshmeri të plotë 6 vite akademike pa asnjë rekomandim nga Këshilli i Akreditimit.

## Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor "FIZIOTERAPI"

### I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** | | | |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Programi i studimit është hartuar konform statutit te Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë dhe qëllimit te Fondancionit ZKM, ne perputhje të plotë me bazën ligjore të miratuar nga institucionet e Republikes së Shqiperisë që rregullojnë veprimtarinënë fushen e arsimit te larte, te cilat nuk bien ndesh me interesat kombetare.<br>*Ref. Statuti UKZKM 2018, neni 2.* | | | |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit Bachelornë "Fizioterapi" në UKZKM synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, në përgatitjen e fisioterapisteve te ardhshëm, sic janë: respektimi i të drejtave themelore të njeriut, barazinë midis anëtarëve të shoqërisë, traditat dhe simbolet kombëtare, sipas një konceptimi që e vë shkencën në sherbim të njeriut dhe te bashkëjetesës paqësore civile.<br>*Ref. Statuti UKZKM 2018, neni 4.* | | | |
| **Kriteri 3.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Referuar statutit të UKZKM *neni 2* dhe *3*, programi i studimit Bachelor "Fizioterapi"eshte në perputhje te plotë me misionin dhe fushën e veprimtarisë të tij. Ai garanton përvetësimin e niveleve të përshtatshme të arsimit për të regjistruarit në këtë programë dhe formon specialistë dhe profesionistë të standardit europian në mënyrë që të mbështesin zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë shqiptare. | | | |
| **Kriteri 4.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Programi i studimit është hartuar për t'iu përshtatur e përgjigjur zhvillimit ekonomik të vendit. Në veprimtaritë e tjera institucionale janë realizimi i projekteve kërkimore shkencore për cështje që lidhen me perspektivat e zhvillimit ekonimik e kulturor të Shqiperisë.<br>*Ref. Statuti UKZKM 2018, neni 3.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi I.2**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Duke iu referuar Planit të Zhvillimit Insitucional paraqitur nga UKZKM për periudhën 2017-2027 mund te themi se, programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi" është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e UKZKM. Në hartimin e programit të studimit është marrë parasysh që organizimi, struktura dhe permbajtja e tij të jetë në |

| | |
|---|---|
| | përputhje me nivelin e kualifikimit të paraqitura në programin e studimeve në "Fizioterapi" në Universitetin "Tor Vegata" dhe në përputhje me strategine e zhvillimit te UKZKM . Konkretikisht Fakulteti i Mejkisë parashikon te organizoj kerkime shkencore në fushat e meposhtëme:<br>Doktoratë në:<br>- Ondontostomatologji<br>- Infiermeri dhe shëndet public.<br>Gjithashtu, parashikon të zgjerojë formimit profesional në programet e mëposhtme të studimit si:<br>Master Ekzekutiv në:<br>- Mjekësi Ligjore<br>- Shkenca të Ushqimit Dietetik të Aplikuar<br>- Kardiologji e Ndërhyrjeve<br>- Ekokardiografi klinike<br>Specializime afatgjata:<br>- Kirurgji të Përgjithëshme dhe Plastike, Trasfuzionale dhe Estetike, Nefrologji.<br>*Ref. Plani i Zhvillimit Insitucional* |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Programi i studimit është hartuar në perputhje të plotë me Statutin e Universitetit, me Rregulloren e Fakultetit te Mjeksisë dhe Rregulloren e Brendshme të UKZKSH. Përmajtja e tij garanton përvetësimin e niveleve të duhura të arsimit për studentët dhe synon të formojë specialistë dhe profesionistë të rinj të standardit europian në mënyrë që të mbështesin zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë shqiptare dhe përparimin e arsimit dhe kërkimit universitar në nivel kombëtar dhe rajonal. Gjithashtu program synon të mbështesë përparësitë strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;<br>*Ref. Statuti UKZKM 2018 neni 2,3, Rregullore e Fakultetit te Mjeksisë neni 2 dhe3.* |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Emërtimi i programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi"është i përshtatshëm për Ciklin e Parë të studimeve. Përmbajtja e tij përputhet me fushën e studimit të UKZKM.Bazuar në vlerësimin e programit të studimit dhe kontrolleve të rastit, grupi i vlerësimit mund të konfirmojë që organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit sigurohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Universitetit.<br>*Ref. Statuti UKZKM 2018.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3**<br>**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët | Programi i studimit ka objektiva të përcaktuar për edukimin dhe formimin e studentëve duke qenë se ky program është në harmoni me misionin e UKZKM, ku ndër të tjera programi synon të formojë |

| | |
|---|---|
| përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. | specialistë të fushës dhe profesionistë të rinj të standardit europian në mënyrë që të mbështesin zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë shqiptare.<br>Për të arritur këto objektiva, programi parashikon përvetësimin e njohurive duke filluar me aspektet teorike të ndjekura nga aspektet praktike.<br>*Ref. Dokumenti nr. 14 Plani I studimit ne Fizioterapi.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Në dokumentacionin shqyrtues janë paraqitur raporte të zyres së Karriers mbi studimin e tregut të punës për studentet e programit të studimit në Fizioterapi. Në analizën e bërë nënvizohet fakti se tregu i punës ka kërkesa të vazhdueshme që i referohen profilit të fizioterapisë si në territorin e vendit tonë ashtu edhe në atë ndërkombëtar.<br>Sipas statistikave të raportit mbi te diplomuarit, nga studimi i tregut rezulton se rreth 93% e të diplomuarëve janë të punësuar pas diplomimit. Në intervistën e bërë me drejtues të zyrës së Karrierës gjatë viziët në ambientet e UKZKM, u tregua mbi bashkëpunimin me institucione shqiptare dhe italiane për punësimin e të diplomuarve.<br>*Ref. Dokumenti nr 105 Raport mbi te diplomuarit ne Fisioterapi.* |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Programi i studimit parashikon harmonizimin e njohurive teorike me ato praktike për realizimin e objektivave mbi forminin e dijeve, aftësitë dhe kompetencat profesionale që synoheshin, dhe që kërkon tregu i punës. Marrja e njohurive në programin e studimit i përgjigjet tregut të punës dhe ua bënë me të lehtë studenteve pershtatjen me mjedisin e punës dhe kerkesat e tij.<br>*Ref. Dokumenti nr. 14 Plani I studimit ne Fizioterapi. Ref. Statuti UKZKM 2018, Dokumenti nr 105 Raport mbi te diplomuarit ne Fisioterapi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.4**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar. | Struktura e fakultetit është e mire organizuar në pëputhje me ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërsië"<br>Nga analiza e CV-ve të personelit akademik të ofruar në këtë program u konstatuan eksperienca, dhe grada sepecifike në fushën e rehabilitimit dhe fizioterpisë. Institucioni ka të gjitha burimet, kapacitetet, përvojen e duhur akademike dhe infrastrukturore në fushen e fizioterapisë per ofrimin e programit te studimit. |

| | |
|---|---|
| | *Ref. Dokumenti 1 VKM 567 2004, Dokumenti 2 VKM 670 2011, Dokumeti 3 Marreveshje per bashkepunim per veprimtarite formuese UKZKM&Tor Vergata. Dokumenti 24, 24.1, 24.2 Cv-të e stafit akademik.* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Sa i takon klasifikimit dhe kodifikimit të përdorur në programin e studimit mund të themi se ka një harmonizim te fushes së pergjithëshme dhe specifike të tij me atë te Faultetit te Mjeksisë tek UKZKM dhe me Universitetin Italian të Romes "Tor Vergata".<br>*Ref. Dokumeti 3, Marreveshje per bashkepunim per veprimtarite formuese UKZKM dhe Tor Vergata: https://eur-lex.europa.eu/legalcontent/IT/TXT/PDF/?uri=CELEX:02005L0036-20140117&from=ES* |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Programi i studimit është hartuar në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore: Fakultetit të Mjekise në UZKM dhe Universitetin Italian të Romes "Tor Vergata".<br>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programet e studimit.<br><br>*Ref. Evidenca nr.14 Plani I Studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Institucioni ka krijuar një bashkëpunim të brendshëm për programin e studimit në lidhje me modelimin, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen.<br>Institucioni i siguron këto marrëdhënie bashkëpunimi brenda tij nëpërmjet ndarjes të detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Njësitë dhe personeli i angazhuar në mirëfunksionimin e programit te studimit ne Fizioterapi, kanë të përcaktuara detyrat dhe rolet në përputhje me objektivat dhe qëllimet e programit.<br>*Ref. Evidenca nr 3 Marrëveshja ndërmjet UKZKM dhe Universitetit të Romës "Tor Vergata.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj. | Intitucioni ne dokumentacionin prezantues liston marrëdhënie bashkëpunimi me institucione italiane dhe shqiptare, në funksion të realizimit të programit të studimit. Grupit te vleresimit iu paraqiten marrveshjet me dokumenta justifikuese lidhur me organizimin e paraktikave dhe ndarje e oreve te praktikave ne institucionet shqiptare dhe italiane. Gjithashtu nga Zyrae Orientimit të Karrierës iu listuan marreveshje me disa institucione për integrimin e të diplomuarve në punësim.<br>*Ref.Evidenca nr.18 Marrëveshja ndërmjet Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë.*<br>*Evidenca nr.19 Marrëveshja Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Spitalit Rajonal të Durrësit.*<br>*Evidenca nr.3 Marrëveshja ndërmjet Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Universitetit të Romës "Tor Vergata".*<br>*Evidenca nr.20 Marrëveshja ndërmjet Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Institutit Santa Chiara Lecce*<br>*Evidenca nr.21 Marrëveshja ndërmjet Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Qendra e Sherbimit Shendetesor "Fratelli Trinità* |
| **Kriteri 3.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Gjatë intervistave të bëra me drejtimin e programit të studimit, u tha se: në fund të çdo viti akademik, koordinatori i programit përgatit një raport analitik të përfitimeve dhe rezultateve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.<br>*Ref. Evidenca nr 3 Marrëveshja ndërmjet UKZKM dhe Universitetit të Romës "Tor Vergata, Evidenca nr.64 Regolamento sulle Funzioni del Nucleo di Valutazione delle Qualita.*<br>*Evidenca nr. 12 Rregullore e Fakultetit* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë. | Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me afat me institucione shëndetësore shqiptare dhe italiane. Me instucionet shqiptare listojmë: Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza në Tiranë, Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë si dhe Spitalin Rajonal të Durrësit. Me institucionet shëndetësore italiane përmendim shtëpin e të moshuarve Fratelli Trinita në Rome dhe Instituti Santa Chiara në Lecce.<br>Të gjitha marreveshjet e bashkëpunimit u verifikuan në dokumentacionin përkatës. Këto marrëveshje shëbejn kryesisht për arritjen e objektivave të praktikave mësimore.<br>*Ref. Evidenca nr.18 Marrëveshja ndërmjet Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë. Evidenca nr.19 Marrëveshja Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Spitalit Rajonal të Durrësit. Evidenca nr.3 Marrëveshja ndërmjet Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Universitetit të Romës "Tor Vergata". Evidenca nr.20 Marrëveshja ndërmjet Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Institutit Santa Chiara Lecce Evidenca nr.21 Marrëveshja ndërmjet Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Qendra e Sherbimit Shendetesor "Fratelli Trinità"* |
| **Kriteri 5.** Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Institucioni ofron formime dhe trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar:<br>• Program Studimi i Diplomës Master në Shkencat Rehabilituese të Profesioneve Shëndetësore<br>• Program Studimi i Doktoraturës Kërkimore në Shkencat e Rehabilitimit ose në Doktoratura të tjera në Fakultetin e Mjekësisë ose Fakultete të tjera<br>• Master dhe Specializime të nivelit të pare. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

**Standardi II.1**
**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i Studimit në Fizioterapiështë organizuar në module dhe vlerësuar në kredite, në perputhje me legjislacionin vendas (*VKM nr.41*) dhe Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ngarkesa e programit eshte 180 kredite e ndare ne 3 vite akademike me nga 60 kredite secili vit. Një krediti i korrespondojne 25 orë mësimore/pune të studentit. Bazuar ne 5 kategorit e VKM nr.41 lendet e paraqitura ne planin e studimit kane respektuar limitet e më poshteme:<br><br>A — LËNDË BAZE — 15% - 20% (kredite)<br>B — LËNDË KARAKTERIZUESE — 50% - 55% (kredite)<br>C — LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE — 12% -15%(kredite)<br>D — LËNDË PLOTËSUESE — 10-15%(kredite)<br>E — DETYRIME PËRMBYLLËSE — 3%-5%(kredite)<br><br>*Ref. Plani I studimit* |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Program i studimit përgatit fizioterapistë, por gjithashtu ai synon të pajisë studentët me njohuri dhe shprehi komplementare, që do tu sherbejnë atyre në punësim. Në program janë parashikuar lëndë e module të etikës, menaxhimit shëndetsor, sociologji dhe psikologji.<br>*Ref. Evidenca nr. 14 Plani I studimit* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Të diplomuarit nga ky program studimi përfitojnë njohuritë dhe kompetecat e duhura profesionale, që nevoiten në tregun e punës si brënda ashtu dhe jashtë vendit. Nepermjet këtij programi synohet që të diplomuarit të jenë në gjendje te punojnë në skuader ,të përbërë nga profesionistë të fushave të ndryshme. Gjithashtu synohet që të diplomuarit të fitojne aftesi për të përcaktuar programin e rehabilitimit për pazient të ndryshëm, në menyrë që të tejkalohen nevojat shëndetësore të tyre. Të jene në gjendje për të praktikuar në mënyrë të pavarur terapitë e sakta për riedukimin funksional të aftësive të kufizuara motore, psikomotore dhe njohëse, duke përdorur terapi manuale dhe fizike për pacientët.<br>*Ref. Evidenca nr. 14 Plani I studimit* |





| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i studimit në Fizioterapi zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar fizioterapeutike. Nëpërmjet lëndëve teorike dhe praktikës synohet qe të aftësohet student, ne mënyrë që të punojë dhe zgjidhë i pavarur këto probleme.<br>*Ref. Evidenca nr. 14 Plani I studimit* |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Hartimi i programit eshte ne perputhje me VKM Nr.41, date 24.01.2018<br>a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);<br>b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;<br>c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale;<br>ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit tëstudimit;<br>d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një programstudimi;<br>dh) planin mësimor;<br>e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;<br>ë) programin lëndor (Syllabus-et);<br>f) profilin e programit;<br>g) diplomën dhe suplementin.<br>*Ref. VKM-së nr.41 date 24.01.2018.* |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Programi i studimit ka të përcaktuar veprimtaritë formuese, duke grupuar modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën respektive në kredite. Ne planin e studimit te programit pesha totale e lëndëve për kategoritë A dhe B respekton limitin >70%, e specifikuar ne aktet ligjore ne rastin Bachelor.<br>Programi ka një kohëzgjatje 3-vjeçare, për një total prej 180 kreditesh, respektivisht me nga 60 kredite në vit. Vlera e 1 krediti është e barabartë me 25 orë. Lëndët grupohen në programe të integruara, sipas ngjashmërisë së fushave formuese. Vlerësimi i provimeve shprehet me të 30 pikë (maksimumi 30) ndërsa nota përfundimtare e diplomes, shprehet në njëqind e dhjetë (110/110).<br>*Ref. Evidenca nr.14 Plani I studimit dhe VKM-së nr.41 date 24.01.2018. Evidenca nr.13 Rregullorja e Programit të Studimit* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Njësia kryesore/bazë përmbush detyrimetligjore për vlerësimin dhe akreditimin, parë kjo si strukture dhe organizim.<br>Ne fuksion te Vleresimit te Brendshem ne kuader te procesit te akreditimit eshte ngritur Grupi i Vleresimit te Brendshem, me propozim të Dekanit të Fakultetit, me Dekretin e Rektorit Nr. 90 Prot. të datës 26.03.2021, i cili |

| | |
|---|---|
| | përbëhet nga figura të ndryshme që kanë luajtur një rol të veçantë gjatë zhvillimit të Programit të Studimit Bachelor në *"Fizioterapi"*. Dekani, në cilësinë e figures përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor të Fakultetit dhe në bashkëpunim me koordinatorin, ndjek nga afër zbatimin e procesit mësimor në përputhje me standardet dhe kriteret e vendosura si në Shqipëri, ashtu edhe në Itali.<br>*Ref. Dokumenti nr 12 Rregullore e Fakultetit te Mjeksise,* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse. | Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit në Fizioterapi kishte caktuar një person Znj. Emanuela Prendi, me detyra te specifikuara qartë, në rolin e koordinatorit të programit të studimit për zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.<br>*Ref. Dokumenti nr 23 Detyrat e Koordinatorit* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.<br><br>**Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. | Programi i studimit plotëson kriteret e nevojshme për sa i takon numrit te personelit, titujve akademike apo shkencore të drejtuesve dhe tituje te stafit akademik. Raporti midis stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjsëshme është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Respektivisht peshat e stafit akademik sipas departamenteve ndahen ne 80% staf akademik nga Universitetit Tor Vergata Rome dhe 20% staf akademik i jashtëm.<br>Përgjegjësit e programit të studimit ne Fizioterapi është koordinatorja, e cila është duke mbrojtur titullin doktor shkencash ne Rome, Itali. Për vitin akademik 2020-20201 njesia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit ka këtë raport PAE/PAK:<br>2020-20201 PAE 5 (2 Prof.As., 3Dr) dhe 5 PAK (1 Prof.Dr., 1 Phd, 3 Msc)<br>Personeli mësimor ne njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, permbushet kryesisht, në raport me numrin e studentëve që udhëheq. Pedagogët e lëndëve jane shqiptarë dhe Italian, ata nënshkruajnë kontrata të rregullta pune me kohë të pjeseshme dhe me kohë të plotë me UKZKM.<br>*Ref. Evidenza nr.70 Tabela pëmbledhëse 1, Evidenza nr.71 Tabela përmbledhëse 2, Evidenza nr. 72 Tabela përmbledhëse 3.* |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. | Universiteti angazhon personel ndihmes në shërbim të laboratorëve e praktikave mesimore. Nga shqyrtimi I Curriculum Vitae te personelit vërehet se, personeli akademik ndihmës zotërojnë të gjitha kushtet e parashikuara nga rregulloret në fuqi dhe të jenë ekspertë të fushës ku ata kontribojne.<br>Evidenca nr.24 Curriculum Vitae (CV) i personelit akademik<br>*Ref. Evidenza nr.70 Tabela pëmbledhëse 1, Evidenza nr.71 Tabela përmbledhëse 2, Evidenza nr. 72 Tabela përmbledhëse 3, Evidenca nr.25 Syllabusi i lëndëve të vecanta, Evidenca nr.24 Curriculum Vitae (CV) i personelit akademik, Evidenca nr.13 Rregullorja mësimore e Programit të Studimit* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Njesia kryesore/baze, përgjegjese për programin e studimit të ciklit të parë në Fizioterapi, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturen dhe permbajtjen e programit te studimit ne harmoni me Universitetin e Romes "Tor Vergata". Konkretikisht fakulteti i "Mjekësisë" ne UKZKM është njësia bazë që kryen këtë funksion, duke patur informacion të plotë për të gjitha veprimtaritë akademike në lidhje me zbatimin e planit mësimor për programin e studimi Bachelor në *Fizioterapi.*<br>*Evidenza nr 3 Marreveshje Bashkëpunimi per veprimtaritë formuese UKZKM & Tor Vegata Rome, Evidenca nr.13 Rregullorja mësimore e Programit të Studimit, Evidenca nr.14 Plani i studimit.* |
| **Kriteri 2.** Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module, në të cilën përfshihet edhe praktika profesionale, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Institucioni ka paraqitur nje plan specifik per zhvillimin dhe shperndarjen e praktikave neper institucione te specializuara si brenda eshtu edhe jashte vendit.<br>*Ref. Dokumenti nr.13 Rregullorja mësimore e Programit të Studimit; Dokumenti nr.14 Plani i studimit. Syllabuset e lendeve.* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Plani analitik i lendeve është ne perputhje me dispozitat ligjore, VKM 41/2018, pika 2.<br>Programi zgjat 3 vite akademike, i organizuar në mësimdhënie me 180 kredite sipas sistemit vendas e atij europian dhe me një shpërndarje të ngarkesës vjetore prej 60 kreditesh ECTS. Një vit akademik është i ndarë ne 2 semestra.<br><br>*Ref. Dokumenti nr.14 Plani i studimit* |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Pjesëmarrja në auditore, stazhe, në orë laboratori dhe veprimtari të tjera praktike kryhet në institucione te percaktuara. Veprimtaritë janë te planifikuara dhe numrin i studentëve është i percaktuar per tu mbuluar rregullisht. Mësimet e ndjekura ne te tilla veprimtari finalizohet me një provimi. Oret e parashikuara ne auditor zënë rreth 66.67% pjesa tjeter e nagrkeses 33.33% zhvillohet ne praktika mesimore.<br>*Evidenca nr. 71 Tabela 2.* |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Rregullorja e Fakultetit te Mjesise permban te gjithë informacionine nevojshëm që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Gjithcka është trasparente për studentët.<br>*Ref. Dokumenti nr 12 Rregullore e Fakultetit te Mjeksise* |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e | Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi" përmban informacionine nevojshem për ngarkesen mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. |

| | |
|---|---|
| laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Informacioni i ofruar për programin e studimit, me lëndët përbërese të tyre pasqyrohen në programin e lëndeve dhe syllabuset e moduleve përbërëse të tyre. Në to jepen të detajuara objektivat formuese të lëndes, konceptet themelore të saj, metodat e mesimdhënies, frekuentimi, temat e lendës, program I lëndës forma e kontrollit te dijeve, literatura e rekomanduar nga docenti. Të gjithë komponentet formues janë në perputhje me formatet e miratuara.<br>*Ref. Dokumenti nr.14 Plani i studimit, Evidenca nr 12 Rregullore e Fakultetit te Mjeksise.* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | UKZKM synon të përmirësoj programet e studimeve nëpërmjet personelit akademik, në perputhje me perditesimin shkencore si dhe të modifikojë kur eshte nevoja metodologjinë e mësimdhënies për të përmirësuar nivelin e përfitimit nga studentët.<br>Per përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies UKZKM konsideron në fillimin e çdo viti akademik mundësinë për modifikimin e metodologjisë duke marrë parasysh edhe sugjerimet e petagogeve dhe studentëve. Permiresimi apo perditesimi behet duke marrë aprovimin nga Universiteti i Romës "Tor Vergata".<br>*Evidenca nr.14 Plani i studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Programi i Studimit ~~të Diplomës Ba~~chelor në "Fizioterapi" ne UKZKM, realizohet në harmoni me Universitetin e Romës "Tor Vergata", për këtë arsye organizimi i programi i studimit, struktura e tij përkojnë me të njëjtin Program Studimi të Diplomës ne "Fizioterapi" të Universitetit Tor Vergata ne Rome, duke respektuar njekohesisht parashikimet ligjore shqiptare dhe ato italiane.<br>*Ref. Evidenza 13 Rregullorja mësimore e Programit të Studimit; Dokumenti nr.14 Plani i studimit. Evidenca nr. 70, 71dhe 72 Tabela1,2 dhe 3. Evidenza nr.25 dhe 25.1 Syllabuset e lendeve* |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. | Emërtimi i programit, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave u mundësojnë studenteve thellim të njohurive duke i garantuar atyre mundesi në punesim si fizoterapist dhe vazhdim të studimeve në cikle të tjera studimi.<br>*Evidenza nr.25 dhe 25.1 Syllabuset e lendeve* |
| **Kriteri 3.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe | Organizimi i programit në Fizioterapi në UKZKM, mundëson arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit që synon ky institucion. Programi është i shpërndarë në tre vite studimi me nga 60 kredite për cdo vit, i ndarë ne 6 semestra. Në total 180 kredite. |

| | |
|---|---|
| rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. | *Ref. Evidenza nr.9 Statuti dhe Evidenca nr.14 Plani i studimit.* |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Në programin e studimit raporti i lëndëve është i ndarë në: lëndë të formimit bazë, karakterizuese, të formimit të përgjithshëm, të shkencave ekzakte, lëndët profesionale, praktikat profesionale. Cdo lëndë eshtë e ndarë në kredite dhe cdo kredit ka orët në auditor dhe jashtë auditorit. Raporti teori-praktike eshte ne perputhje me profilin e programit bachelor dhe eshte i njëjtë gjithashtu dhe me programin e studimeve në Fizioterapi në Universitetin e Romës "Tor Vergata".<br>*Ref. Dokumenti nr.14 Plani i studimit* |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Raporti midis formimit teorik dhe praktik, shpreh qartë synimin për formim profesional të këtij program studimi. Peshat ndahen respektivisht ne 66.67% formim teorik dhe 33.33% formim praktikë. Në këtë këndveshtrim mundësohet arritja e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.<br>*Ref. Dokumenti nr.14 Plani i studimit, Evidenca nr. 70, 71 Tabela1,2.* |
| **Kriteri 6.** Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Programet e lëndëve/moduleve përditesohen në menyre të vazhdueshme duke u bazuar në literature recente. Çdo vit akademik, pedagogët dërgojnë literature të azhornuara duke mundesuar kopje të tyre në bibloteken e universitetit.<br>*Ref. Evidenca nr.25 dhe 25.1 syllabuset* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. | Program i studimit te ciklit të parë në Fizioterapi garanton perfitimin e dijeve jo vetem në fushën e rehabilitimit, por gjithashtu ai synon të pajis studentët me njohuri dhe shprehi komplementare, që do tu sherbejnë atyre në punësim. Ai kombinon teorine dhe praktiken duke synuar nxitjen e studenteve per pervetesimim te kompetencave ne fushen e fizioterapise.<br>*Ref. Plani I studimit* |
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Programi i studimit është hartuar duke pasur në konsider zhvillimin ekonomik dhe perspektiven e tregut te punes ne Shqiperi.<br>Permbajtja e programit te studimit u mundeson studenteve thellim te njohurive duke i garantuar atyre mundesi ne ndjekjen e studimeve te ciklit te dyte.<br>*Ref. Evidenca nr.14 Plani i studimit* |
| **Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | UKZKM mban kontakte të vazhdueshme me organe dhe institucionet shëndetësore që operojnë në tregun e punës, ne menyre që te jete i azhornuar për cdo permiresim te mundeshem ne programin e studimit ne Fizioterapi.<br>GVJ konstatoi pjesëmarrje në Urdhra Profesional (i mjekut dhe infermierit) dhe cdo vit në panairin e punës ne Tiranë.<br>*Ref. Evidenca nr.14 Plani i studimit, Evidenca 105 Raport mbi te diplomuarit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi II.5**

| **Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. | I gjithë personeli akademik i brëndshem dhe i jashtëm i angazhuar në procesin e mesimdhenies në UKZKM, janë të gjithë të kualifikuar me gradat shkencore dhe me tituj akademik përkatës sipas kërkesave ligjore. *Evidenca nr. 70, 71 Tabela1 dhe 2.* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | Personeli akademik, si PAK edhe PAE realizon ngarkesën mësimore në përputhje me planin e studimit sipas oreve e krediteve për secilin lëndë/ modul. Ata kanë tituj akademike Profesor, As Profesor, apo gradë shkencore Dr. si për PAE dhe PAK. Personeli akademik mbulohet në 80% nga PAE dhe 20% nga PAK.<br>Për 3 vitet e fundit akademike raporti midis PAE dhe PAK është si më poshtë:<br><u>2020-20201</u> PAE 33 (3 Prof., 4 Prof.As., 20 Phd, 6 Msc.) dhe 31 PAK (4 Prof., 2Prof.As., 3 Phd, 22 Msc)<br><br><u>2019-2020</u> PAE 33 (3 Prof., 3 Prof.As., 21 Phd, 6 Msc) dhe 28 PAK (3Prof., 1 Prof.As., 3 Phd, 21 Msc)<br><br><u>2018-2019</u> 31 PAE (4 Prof., 3 Prof.As., 19 Phd, 5 Msc) dhe 30 PAK (3 prof., 1 Prof.As, 4 Phd, 21 Msc)<br><br>*Evidenca nr. 70, 71 Tabela1 dhe 2.* |
| **Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kerkimore e përgjithshme dhe specifike e antarëve të personelit akademik, kualifikimet e tyre akademike dhe eksprienca e gjate ne mesimdhenie, qe mbulon programin e studimit, është në perputhje te plotë me natyrën dhe specifikën e moduleve të programin e studimit, ku janë te perfshire në mesimdhënie *Evidenca nr. 70, 71 Tabela1 dhe 2; Evidenca nr.24 Curriculum Vitae (CV) i personelit akademik* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | UKZKM ka lidhur një seri marrëveshjesh me institucione publike dhe private për të mbështetur studentët në praktikat profesionale. Studentet e ketij programi kane nje udheheqje efikas dhe mbikqyrje të vazhdueshme të mbarvajtjes në gjithë hapat për realizimin e programit.<br>*Ref. Evidenza nr.17 Marrëveshje me Spitalin e Traumes, Evidenza nr. 18 Marrëveshje me Qendrën Spitalore Nënë Tereza, Evidenza nr. 19 Marrëveshje me Qendren Spitalore Durres. Evidenza nr.20 Marrëveshje me Insititutin Santa Chiara Lecce. Evidenza nr.21 Marrëveshje me Insititutin Fratelli Trinita.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e | UKZKM siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës tëpërshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike/praktikave dhe për |

| | |
|---|---|
| laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.<br>*Evidenca nr. 70, 71 Tabela 1 dhe 2.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

**Standardi III.1**
**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. | Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Institucioni dhe vizita në ambientet e tij, GVJ konstaton se, UZKM ofron nje mjedis modern dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit. Gjithashtu UKZKM siguron auditore për leksione me strukture moderne dhe të përshtatëshme, klasa për seminare, laboratorë të ndryshëm, palestra, pishine, të cilat janë të paisura me mjete te teknologjisë së fundit.<br>Fakulteti përditësohet vazhdimisht në lidhje me zhvillimet e udhëzimeve për disiplinave dhe moduleve të mësimdhënies. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | Forma kryesore e vlerësimit dhe verifikimit të progresit të veprimtarive akademike dhe administrative në lidhje me veprimtarinë mësimore zhvillohet nëpërmjet procesit të vlerësimit të studentëve për mësimdhënien dhe për personelin akademik dhe ndihmes akademik. Një raport mbi rezultatet e shprehura nga studentët i paraqitet çdo vit Rektorit.<br>*Ref. Evidenca nr.25 dhe 25.1 syllabuset* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Një menyre tjetër e marrjes së mendimeve të studentëve është mbajtja e takimeve mujore me ta. Gjate vizites ne aktivitet GVJ i'u tregua se, takimet zhvillohen me studentë të të gjitha viteve dhe organizohen nga koordinatori i programit të studimit. Nepermjet plotesimit të pyetesoreve që shpendahen tek studentët gjatë gjithë vitit për cdo module, garantohet përfshirja e tyre në vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies. Nga strukturat përkatese është përfshirë mundësia e trajtimit të ankimimeve, si e drejte e studentëve per cdo provim.<br>*Edivenca nr. 30 Perceptimi I studenteve per veprimtarine mesimore.* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë | Rezultatet e vleresimit të pedagogeve behen publike nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. |

| | |
|---|---|
| në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Studentëve vazhdimisht gjatë vitit akademik u prezantohen kuestionar per studimet e vlerësimeve.<br>*Ref. Evidenca nr. 64 Rregullore mbi Funksionet e njësisë së Vlerësimit të Cilësisë.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. | UKZKM, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Një formë qe UKZKM ndjek është marrja e mendimeve të studentëve dhe mbajtja e takimeve mujore me studentët. Këto takime zhvillohen me studentë të të gjitha viteve dhe organizohen nga Koordinatori i Programit të studimit.<br>*Ref. Evidenca nr. 64 Rregullore mbi Funksionet e njësisë së Vlerësimit të Cilësisë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Format e mesimdhenies ne progamin e studimit Bachelor ne Fisioterapi jane leksionet, seminaret, ushtrimet, laboratoret, praktika mesimore, detyrat e kursit etj. Studentët gjithashtu marrin pjesë në konferenca shkencore dhe arsimore, seminare dhe leksione të hapura të mbajtura nga bashkëpunëtorët tanë, profesionistë të sektorit shëndetësor, si të huaj ashtu edhe kombëtar<br>*Ref. Dokumenti 31 - Lista e aktiviteteve shkencore dhe didaktike me seminare e konferenca. Evidenca nr.14 Plani i studimit.* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. | Personeli akademik ne UKZKM angazhohet për të ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit bachelor ne Fizioterapi në përgjithësi dhe specifikisht per module te vecanta gjithashtu është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. Mund të pëmendim këtu mësimdhënien on line.<br>*Ref. Evidenca nr.14 Plani i studimit, Evidenca nr.25 dhe 25.1 syllabuset* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të | Istitucioni mbështet personelin e tij në përdorimin e metodologjive novatore, që ndihmojnë studentët të përmirësojnë kompetencat e reja dhe të përmbushur kërkesat e tregut të punë dhe kërkesat e punëdhënësve. Personeli akademik gjatë mësimdhënies përdor metoda të ndryshme dhe fleksible për studentët. Mësimdhënia në distancë është |

| | |
|---|---|
| të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | një metodë fleksbël që u perdorë gjerësishtë gjatë vitit akadmeik 2020-2021.<br>*Ref. Evidenca nr.24 Curriculum vitae personelit akademik* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Personeli akademik i perfshire ne mesimdhenie ne progamin e studimit ka nje eksperience shume vjecare ne mesidhenie. Ne shqyrtimin e disa CV-ve rastesore te stafit akademik u vune re, gradat dhe tituj akademik te tyre.<br>*Ref. Evidenca nr.24 Curriculum vitae personelit akademik* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Në fakultetin e Fizioterapisë në UKZKM zhvillohet një proces vlerësimi i metodologjive të mësimdhënies, që përfshin në të edhe studentët, duke marrë mendimet dhe sugjerimet e tyre. Këto metodologji miratohen nga pedagogët që përfshijnë edhe studentët me ballafaqime te ndryshme. Personeli akademik inkurajon autonominë e studentëve dhe mendimin e tyre kritik nëpërmjet mësimdhënies active.<br>*Ref. Evidenca nr.24 Curriculum vitae personelit akademik* |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Lektori pergjegjes nderthur metoda interaktive te tjera si puna ne grupe e cila nxit partneritet ndermjet studenteve dhe procesi mesimor behet me terheqes. Punimet në grupe paraqiten ballafaqimet apo diskutimet ne klasë jane disa nga metodat që personeli akademik ne UKZKM përdorë gajtë orëve të mësimit.<br>*Ref. Evidenca nr.24 Curriculum vitae personelit akademik, Evidenca nr.25 dhe 25.1 syllabuset* |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Gjate intervistave, GVJ kontantoi se personel akademik perdorë forma dhe metoda gjatë mësimdhënies ku përfshihen edhe studentët (diskutime te hapura, projeKte ne grupe etj).<br>Personeli akademik synon të perdorë metodika, që inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit mes njëri-tjetrit.<br>*Ref. Evidenca nr.24 Curriculum vitae personelit akademik, Evidenca nr.25 dhe 25.1 syllabuset* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat | Të gjitha ambientet në UKZKM të vizituara nga ekipi i vleresimit të vëna në dispozicion për studentet, ishin bashkohore me hapsirat e nevojshme, të pastra dhe te mirëmbajtura, për të mundësuar një mësimdhënie me cilësi të lartë. |

| | |
|---|---|
| janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | *Ref. Evidenca nr. 48 Certifate Pronësisë* |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me iogjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. | Cdo salle mesimore ne UKZKM eshte e pajisur me PC, projektor, internet dhe kondicionim, për realizimin me cilësi të procesit mësimor. Gjithashtu në ambientet e UKZKM për kryerjen e praktikavegjendet një plaster bashkohore me pishinë dhe me paisje mjkesore modern për kryerjen e praktikave.<br>*Ref. Evidenca nr. 48 Certifate Pronësisë* |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. | Personeli akademik paraqitet fleksibel e përdor metoda interaktive dhe diskutimi gjatë mësimdhënies. Në ambientet e UKZKM janë në dispozicion për të gjithë studentët laburatore kompjuterësh dhe personel It per realizimin e projekteve apo kërkimeve të ndryshme. Gjithashtu UKZKM ka krijuar një Portal si pikë kryesore e informacionit dhe bashkëpunimit midis Universiteti dhe studentëve.<br>*Ref. Evidenca nr 34 Rregullorja e përdorimit të mjeteve informatike.* |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. | Ne syllabus-et e analizuara, u ve re se format dhe metodat e mësimdhënies synojne te inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, dhe mbështetjen nga mësimdhënësi ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. Literatuara baze dhe ndihmese e pasqyruar ne syllabus-e garanton marrjen e dijeve dhe njohurive te nevojshme, te parashikuara ne programin e studimit.<br>*Evidenca nr.25 dhe 25.1 syllabuset* |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Biblioteka "Paolo Ruatti" e UKZKM, u ofron studentëve dhe pedagogëve një literaturë akademike shumëdimensionale. Nëpërmjet sugjerimeve, kërkesave, vëzhgimeve dhe ankesave, Biblioteka pasurohet në mënyrë periodike. Librat në bibliotekë janë në gjuhë të ndryshme dhe formatet (në letër ose në format elektronik). Për të mbështetur procesin akademik dhe kërkimin shkencor, biblioteka vë në dispozicion të përdoruesve bashkëpunimin e saj me bibliotekat e tjera nëpërmjet OPAC dhe CDD.<br>*Ref. Dokumenti 33 Rregullore e Biblotekes.* |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Biblioteka "Paolo Ruatti" e UKZKM, u ofron falas studentëve dhe pedagogëve ne funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, akses te librave on-line dhe hardcopy. Bibloteka me shërbimet e saj është ne dispozicion te studtëve nga ora 08:30 deri 19:00- nga e Hëna deri të Premten, ndërsa ambientet e studimit janë të hapur nga e Hëna deri të Djelen ne orarin 08:00-21:00.<br>*Ref. Dokumenti 33 Rregullore e Biblotekes* |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Ne ambientet e UKZKM janë në dispozicion për të gjithë studentët laburatore per realizimin e projekteve apo kërkimeve të ndryshme detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike. Ato shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët dhe stafi akademik. |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Ky kriter gjeti nje zbatim absolut në Pandemi duke patur nje pjesmarrje dhe angazhim te plotë nga të dy palet, stafit akademik dhe studentëve.<br>Gjatë vitit akademik 2020-2021 personeli akademik dhe studentet përdoren platforma on-line/e-learning (si Classroom) per leksionet, testimet e njohurive dhe praktikat mesimore. Pjesëmarrja gjatë elearing rregjistrohej |

| | |
|---|---|
| | dhe arshivohej ne meet. Klasat virtuale mundesonin feedback te studenteve dhe stafit akademik. |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. | Lektorët dhe studentët, kanë hapsirat e tyre ne sistemin informatik të UKZKM dhe e shfrytëzojnë këtë sistem komunikimi per nevoja të ndryshme gjatë vitit akademik, sic jane emailet e docenteve apo akesim ne platformat e ndryshme te mesimdhenies ne distance.<br>*Ref. Evidenca nr.34 Rregullorja e përdorimit të mjeteve informatike.* |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Për sa i përket diskutimit të tezës, personeli akademik është përgjegjës për udhëzimin e studentëve në zgjedhjen e temave, në bazë të preferencave të tyre. Studentet udhehiqen nga nje pedagog i fushes i cili propozohet nga studenti, dhe me pas miratohet nga instancat e tjera drejtuese akademike te universitetit.<br>*Ref. Rregullore e tezes se diplomes.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | UKZKM ka organizuar strukturat/ njësitë të tilla si: koordinatorët e programeve, zyra e karrieres, duke synuar që nëpërmjet tyre të promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë, me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.<br>*Ref. Evidenca nr. 64 Rregullore mbi Funksionet e njësisë së Vlerësimit të Cilësisë* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | Ne UKZKM njesia kryesor Fakulteti I Mjekësisë dhe ajo baze Fakulteti I Fizioterapië dhe departamentet e tij, jane pergjegjese për sigurimin e cilësisë se mësimdhënies dhe ndërgjegjsimin e personeli akademik dhe studentëve për cilësinë në programet e studimit.<br>*Ref. Evidenca nr. 64 Rregullore mbi Funksionet e njësisë së Vlerësimit të Cilësisë* |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | UKZKM shfaq disponibilitet nëpërmjet strukturave dhe njësive përgjegjëse, të mbështesi eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, si psh mësimdhënia on line ne plaformat e disponueshme ne rastet e nevojshme.<br>*Ref. Evidenca nr. 64 Rregullore mbi Funksionet e njësisë së Vlerësimit të Cilësisë* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Personeli akademik dhe ai mbështetës ne UKZKM kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme, për të fituar titujt e gradat shkencore, në përputhje me prioritetet e tyre në fushën e kërkimit shkencor dhe plotesimit te kerkesave ligjore. Kjo gjë ndihmon edhe ne përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, nëpërmjet pjesëmarrjes së pedagogëve në konferenca, programe, organizim dhe menaxhim të projekteve dhe grupeve kërkimore. |

| | |
|---|---|
| | *Ref. Evidenca nr. 64 Rregullore mbi Funksionet e njësisë së Vlerësimit të Cilësisë* |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Kryesisht personeli akademik ne UKZKM angazhohet në trajnime e kualifikime shkencor gjë që ndihmon edhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Ne buxhetin e UKZKM cdo vit parashikohet nje fond mbeshtetes per botimet shkencore te personelit akademik. *Ref. Evidenca nr. 64 Rregullore mbi Funksionet e njësisë së Vlerësimit të Cilësisë* |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Personeli akademik dhe personeli ndihmës bazuar janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Dekani i Fakultetit të Mjekësisë në cilësinë e përgjegjësit për programin e studimit dhe koordinatori I programit vazhdimisht përpiqen të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies, për këtë qëllim, ata krijojnë programe dhe metodologji të përshtatshme të mësimdhënies për të siguruar rezultatet e paracaktuara *Ref. Evidenca nr. 64 Rregullore mbi Funksionet e njësisë së Vlerësimit të Cilësisë* |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Si personeli akademik dhe personeli ndihmës vazhdimisht testojnë metoda të reja në mësimdhënie. Mund te permenden punët në grupë, porjekte gjate vitit akademik apo mesimdhenie ne distance. Ne fund te cdo moduli studentet paqasesin opinionin e tyre lidhur me metodat e ndjekura per mësimdhënie nga personeli akademik. *Ref. Evidenca nr. 64 Rregullore mbi Funksionet e njësisë së Vlerësimit të Cilësisë* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5** **Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Bazuar ne Rregulloren e Provimeve te Universitetit, testet kryhen disa herë për çdo semester, në mënyrë që t'i jepet mundësia secilit student të kalojë vlerësimin pasi të kenë përfunduar njohuritë e tyre mbi cdo lende. Ne kete rregullore janë të përcaktuara qartë kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjatë vitit akademik jane 3 sesino per provimet: sesioni I dmirit, I verës dhe i vjeshtës. Përgjegjësi I lëndës harton në cdo session programin e provimeve. <br><br> *Ref. Dokumenti nr 38 Rregullore e provimeve.* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Bazuar në Rregulloren Universitetit, personeli akademik në fillim të çdo lënde/moduli informon studentët me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. *Ref. Dokumenti 25 dhe 25.1 Syllabus* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Rregullorja e Provimeve parashikon që vlerësimi i një lënde mund të bëhet me provim me shkrim, me gojë ose të kombinuar; prezantime, projekte etj. Ky kombinim në mënyrën e vlerësimit i ofron studentit më shumë mundësi për të treguar njohuritë dhe aftësitë e fituara. Provimet gjate<br><br>*Ref. Dokumenti nr 38 Rregullore e provimeve* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. | Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore i studentëve realizohet sic është parashikuar në rregullore e syllable, gjate gjithe vitit akademik. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentëve bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultat i një kombinimi te projekteve apo puneve ne grup, detyra praktike, aktivizimit ne seminare si dhe testimit finale (me shkrim apo goje).<br>*Ref. Evidenca nr.38 Rregullorja e Provimeve* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat, vecanerisht per lendë/module te karakterit informatike. Softëare përdoret kryesisht për të dhënë provime dhe per tu monitoruar gjate provimit në mënyrë elektronike.<br>*Ref. Evidenca nr.38 Rregullorja e Provimeve* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Bazuar në Rregulloren e Provimeve vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë. Titullari i lëndës është kryetar I komisionit i asistuar nga 1/2 anëtar |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | UKZKM ka krijuar mekanizmat që gjatë procesit të vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, testimi të zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni ka siguruar infrastrukturën e posaçme. Pedagogu i lendes gjate vlersimit te testimit me shkrim nuk eshte i njohur me asnje kredencial te studentit. Gjithcka behet trasparente gjate dhenies se rezultateve perpara komisionit dhe gjithe studenteve.<br>*Ref. Evidenca nr.38 Rregullorja e Provimeve* |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Komisionit të Provimit i kërkohet t'i shpjegojë studentit vlerësimin e bërë dhe nëse provimi është edhe në formë të shkruar, të ballafaqojë përgjigjet e studentit me tezën e zgjidhur, duke e ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen.<br>*Ref. Evidenca nr.38 Rregullorja e Provimeve* |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin | Personeli akademik gjate testimit të njohurive, dijeve me shkrim, siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi |

| | |
|---|---|
| plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. | duke respektua rrregulloren për zhvillimin e testimeve. Masat dishiplinore që merren nga petagogu gjatë testimit për mos respektim te rregullores jane:<br>a- Vërejtje me gojë<br>b- Përjashtim nga provimi (kjo mase shoqerohet me vlerësim negative.<br>*Ref. Evidenca nr.38 Rregullorja e Provimeve* |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet bëhen të njohura brenda 3 ditëve (72 oresh) nga dita e zhvillimit të tij.<br>*Ref. Evidenca nr.38 Rregullorja e Provimeve* |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Studentët kanë të garantuara nga Universiteti të drejtat për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të pedagogut të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Dekanit te Fakultetit.<br>*Ref. Evidenca nr.38 Rregullorja e Provimeve* |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | Çdo kërkesë, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet ne dekanat.<br>*Ref. Evidenca nr.38 Rregullorja e Provimeve* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit eshte i organizuar në lëndë/module dhe praktika, përmbajtja e tyre dhe metodat e mësimdhënies krijojnë mundësinë dhe garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve.<br>*Evidenca nr.14 Plani i studimit, Evidenca nr. 9 Statuti* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Ne planin e studimit te Fakultetit te Fizioterapise ne UKZKM, nje pjese e lendeve i është dedikuara disiplinave që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe bioteknologjinë, nje pjese tjeter shkencave shoqërore dhe shkencave humane: ofrohen lende në Sociologji dhe Psikologji. Ne planin e studimit jane perfshire 2 gjuhe te huaja.<br>*Evidenca nr.14 Plani i studimit, Evidenca nr. 9 Statuti* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e | Ne programin e studimit te Fakultetit te Fizioterapise, pershkruhen kompetencat dhe aftesite qe fiton studenti ne perfundim te lendes. Ne |

| | |
|---|---|
| çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | varesi te tipologjise se lendes/modulit pershkruhen dhe kompetencat e te nxenit. *Evidenca nr.14 Plani i studimit, Evidenca nr. 9 Statuti* |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. | Ne perfundim te cdo lende/moduli, lektori pergjegjes ne oren e fundit te leksionit kryen nje permbledhje te tematikave mesimore te zhvilluara pergjate programit. Gjithashtu lektori eshte pergjegjes per orientimin e studentit në ceshtjet e rëndesishme të lëndëve për provimin përfundimtare. Per cdo paqartesi gjate periudhes se studimit dhe testimit te modulit student kerkon ballafaqim idesh me pergjegjesin e lendes. *Evidenca nr.14 Plani i studimit* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Gjate intervistave të GVJ me drejtues, personel akademik dhe student u konstatua se, në programin e studimit personeli akademik siguron mundësi per te krijuar ore te hapura ne trajten e leksioneve dhe laburatoreve me studentet me tematika jashte strukturës së programit të studimit. *Evidenca nr.14 Plani i studimit* |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Në përmbajtjen e programit i është dhënë vemendje e vecante laboratorëve dhe praktikatve profesionale. Praktikat zene rreth 33.34% te peshesh se mesimdhenies vjetore. Kjo gje u jep studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në keto laboratorë dhe praktikat profesionale. *Evidenca nr.14 Plani i studimit* |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Personeli akademik shpreh solidaritet në mbështetjen e studentëve për problemet e mbarvajtjes së studimeve. Puna në grupe dhe momentet e debatit mbi rastet e studimit përfaqësojnë mënyra efektive për t'i mësuar studentët me punën në grup dhe interaktivitetin midis tyre dhe lektorit te lendes. *Ref. Dokumenti 25 dhe 25.1 Syllabus* |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. | Personeli akademik mundeson frymen e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me studentet që ndjekin programin e studimit bachelor ne Fizioterapi. Kjo gjë reflektohet tek puna në grupe që përgjegjesi i lëndes organizon me studentët. *Ref. Dokumenti 25 dhe 25.1 Syllabus* |
| **Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët. | Misioni i UKZKM është të mbështesë zhvillimin e ideve novatore, kërkimeve të avancuara dhe të studimeve shkencore, në të cilat përfshijnë edhe studentët. Edhe pse fondet për studimet e avancuara në kërkimet rezultuan modeste, GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se Universiteti ishte duke punuar mbi *projektin sodality, I cili* inkurajon fianciarisht nismat për projekte novatore. *Ref. Dokumenti nr.11 Plani Strategjik Institucional.* |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | UKZKM në bashkëpunim me Universitete të tjera Europiane, në kuadër të ndërkombëtarizimit, merr pjesë në programe që favorizojnë lëvizshmërinë e studentëve dhe personelit akademik administrativ nga dhe për në Shqipëri, siç është veprimi Lëvizshmëria Ndërkombëtare e Kredive - International Credit Mobility (KA107) të programit Erasmus. *Ref. videnca nr.11 Plani Strategjik Institucional.* |

| | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | | | X |
|---|---|---|---|---|

| Standardi III.8<br>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Institucioni ka procedurë të qartë të miratuar për provimin final dhe diplomimit të studentëve. Ajo është pasqyruar edhe në rregulloret përkatëse të Universitetit.<br>*Ref.Dukumenti nr.7 Regullore e temes se diplomes per programin e studimit Fiziterapi: Dokumenti nr.35 Formulari I kerkeses per temen e diplomes.* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Ne UKZKM udheheqesit e temes se diplomes zgjidhen nga vete studentet dhe miratohen nga strukturat pergjegjese. Ne vitin e 3-te te studimit, studenteve u mundesohen nga Institucioni, konsulenca dhe suporti i duhur per te realizuar kerkimin shkencor sa itakon provimit final.<br>*Ref. Evidenca nr.27 Rregullorja e Diplomës* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Komisioni i posacem për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohurivete dhëna gjatë 3-viteve akademike, duke patur informacion dhe përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Komisioni i caktuar nga Rektori, me propozimin e Dekanit të Fakultetit, vlerëson në mënyrë të përshtatshme karrierën e studentit dhe merr parasysh vlerësimin e tezës dhe përfundon me një notë përfundimtare.<br>*Ref. Evidenca nr.27 Rregullorja e Diplomës.* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. | Personeli akademik ne UKZKM, orientojnë dhe ndihmojnë studentët duke I orientuar studentet per kerkimin dhe siguruar informacione dhe materiale të nevojshme për tezën e diplomës. Relatori udhëheqës dhe bashkëmbikëqyrësi (korelatori), janë dy personat që ndjekin dhe mbështesin studentin në përgatitjen e provimit final.<br>*Ref. Evidenca nr.27 Rregullorja e Diplomës. Evidenca nr.43 Rregullorja mbi veprimtaritë e Sekretarisë Mësimore* |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Institucioni përcakton një staf akademik nëpërmjet të cilit, ndihmon dhe orienton studentët për kyerjen e testimit të kualifikimit professional (urdhri professional), përpara se të gjykohet mbi vleresimin përfundimtar të studentëve në prezantimin e temes së diplomës.<br>*Ref. Evidenca nr.27 Rregullorja e Diplomës* |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Procedura e tezës së diplomes ndiqet nga relatori udhëheqës i diplomës, i cili asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar nga rregulloret e Universitetit. GVJ gjatë takimeve me koordinatoren dhe sekretaren e programit u tregua se relatori kontrollon dhe rregullon kur nevojitet, cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit ne testimin final.<br>*Ref. Evidenca nr.27 Rregullorja e Diplomës.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Komisioni i caktuar nga Rektori I UKZKM, me propozimin e Dekanit të Fakultetit te Fizioterapise, vlerëson në mënyrë të përshtatshme karrierën e studentit dhe merr parasysh vlerësimin e tezës dhe përfundon me një notë përfundimtare.<br>*Ref. Evidenca nr.27 Rregullorja e Diplomës.* |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Studenti në përfundim të mbarimit të studimeve prane UKZKM, pajiset me listën e notave, suplementin e diplomes dhe diplomën, formati i së cilës është miratuar nga MASR (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), në përputhje me Dekretin Nr. 10, të datës 30.03.2020. Suplementi i diplomës është në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucione" dhe në përputhje me Dekretin nr. 11, të datës 02.04.2020.<br>*Ref. Dokumenti 42 Modeli I Pregamenes.* |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studenti në përfundim të studimeve nepermijet nje kerkese drejtuar Sekretarise Mesimore, pajiset me dokumentacionin përkates zyrtar të nevojshem.<br>*Ref. Evidenca nr.43 Rregullorja mbi veprimtaritë e Sekretarisë Mësimore* |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. | Institucioni ruan në arkivat e tij, për një periudhë të pacaktuar kopje te dokumentacionit te studentit.<br>*Ref. Evidenca nr.27 Rregullorja e Diplomës. Evidenca nr.43 Rregullorja mbi veprimtaritë e Sekretarisë Mësimore* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program | GVJ në vizitën e realizuar në institucion sipas agendës së realizuar nga koordinatori i ASCAL, në takimin me dekanin (për palën italiane), si dhe në takimin me përfaqësuesen e burimeve njerëzore u informua se cdo vit akademik dekani dorëzon performancën e punës së stafit akademik tek |

| | |
|---|---|
| dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | rektori dhe cdo 4 muaj dërgohet performanca e personelit në zyrën e burimeve njerëzore. Performanca vlerësohet sipas një pyetësori të aprovuar më parë në senatin e UZKM. Po kështu GVJ u informua dhe konstatoi se krahas dokumentacionit për rekrutimin e stafit te ri akademik me dokumentat si më poshtë (kërkesa, CV, diploma, listë notash të noerizuara, tituj grada të noterizuara, raporti mjeko ligjor, fotokopje e kartës së identitetit, experience në punë, artikuj publikime të ndryshme), cdo fillim viti akademik bëhet përditësimi i dosjes së personelit. Deparatmenti i Burimeve njerëzore ruan, arshivon, administron dokumentacion e plotë si dhe përditësimet e bëra për cdo vit, për stafin akademik, ndihmës akademik të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrative.<br><br>*Evidenca nr.44 Bashkëlidhet Formati i Dosjes individuale të personelit* |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | GVJ konstatoi gjatë vizitës ne institucion te UZKM se,<br>Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe rregulloren e brendshme të institucionit. Bazuar në ngarkesën mësimore sipas programit mësimor të diplomës Fizioterapi bëhet kërkesa nga njësia bazë, te dekani dhe më pas kërkesa dërgohet te rektori. Gjithashtu per sa i perket stafit akademik italian, GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me zyrën e burimeve njerëzore, konstatoi se rekrutimi i tyre realizohet ne kuader te Marrveshjes se bashkëpunimit me Universitetin e Tor Vegata të Romës.<br>*Evidenca nr.3 Marrëveshja ndërmjet Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë dhe Universitetit të Romës "Tor Vergata";*<br>*Evidenca nr.45 Rregullorja e procedura vetë menaxhimit të Burimeve Njerëzore* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | GVJ konstatoi se institucioni i ZKM-së ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura sipas programit të studimit, sipas modulit përkatës, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.<br>Procedura e rekrutimit bëhet në fillim të vitit akademik, por nuk përjashtohet mundësia e rekrutimit gjatë vitit sipas largimevepër arsye të ndryshme të stafit të rekrutuar më pare (arsye shëndetësore, vdekje, dhe ndryshime të vendit të punës). Cdo procedurë realizohet në faqen zyrtare të internetit të ZKM (ofertat e punës)<br>*http:/ëëë.unizkm.al/index.php/primo-piano/offerte-di-lavoro* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në | Gjate vizitës në institucion GVJ, ju vendosën në dispozicion dosje të zgjedhura në mënyrë të rastësishme të stafit të rekrutuar në vite. U zgjodhën 2 dosje të vitit akademik 2020-2021.<br>Institucioni sic përshkruam dhe më lart, harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e |

| | |
|---|---|
| përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | akteve rregullatore dhe i bën ato publike. Bazuar në ngarkesën mësimore sipas programit mësimor të diplomës Fizioterapi bëhet kërkesa nga njësia bazë,te dekani dhe më pas kërkesa dërgohet te rektori. Krahas kërkesës bëhet e qartë kriteret specifike të arsyes se kësaj kërkese, moduli ku është i nevojshëm ky staf. Përpilohen kriteret e pranimit, publikohen në faqen zyrtare on-line të institucionit së bashku me afatet e pranimit të dokumentacionit. Pastaj një komision add-hoc i ngritur nga Rektori I ZKM-së, vlerëson dosjet e kandidatëve dhe bëhet rekrutimi. Informohet kandidati fitues, por dhe për kandidatin jo fitues, bëhet informimi dhe sqarimi për arsyen, pse nuk është i përzgjedhur.<br>Ref.*http://ëëë.unizkm.al/index.php/primo-piano/offerte-di-lavoro*<br>*Evidenca nr.46 Shpalljet e thirrjeve për përzgjedhjen e personelit akademik dhe administrativ* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. Kjo teknologji innovative u zbatua maximalisht në vitin 2019- 2020, 2020-2021 për shkak të situatës pandemike, duke zhvilluar mësimin on-line.<br>Në faqen ëeb Universiteti ka të publikuara këto metoda inovative si për sutudentët edhe për personelin akademik. Në vijim linket respektive:<br>https://ëëë.unizkm.al/posts/slug/guida-per-i-docenti?highlight=manuale%20<br>https://ëëë.unizkm.al/posts/slug/guida-per-gli-sudenti?highlight=manuale%20 |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | GVJ bazuar në të dhënat gjatë vizitës në institucion , raportin e vlerësimit të brendshëm, takimin me drejtuesit e institucionit si dhe stafin akademik u informua se personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme realizohen kualifikime të vazhdueshme , falë bashkëpunimit që kanë dhe me Universitetin Tor Vegata të Romës. Institucioni gjithashtu mbikqyr dhe asiston kualifikimet e stafit akademik për vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucion ose në institucione partnere. Institucioni po ashtu stimulon kërkimin shkencor të stafit akademik dhe të studentëve duke bërë të mundur mbulimin e shpenzimeve si: fee e pjesëmarrjes në konferenca / kongrese / seminare kombëtare dhe ndërkombëtare, publikime të ndryshme shkencore. Institucioni në plan buxhet e planifikon zërin e shpenzimeve të aktiviteteve shkencore, si mbulimin e shpenzimeve për |

| | |
|---|---|
| | shkëmbime përvojash me kolegë nga universitetet partnere si: (ERASMUS,Universitetin Tor Vegata) nëpërmjet sesioneve dhe seminareve të përbashkëta<br>*Evidenca nr 31:Lista e aktiviteteve shkencore dhe didaktike me seminare dhe konferenca*<br>*Evidenca nr.47 Formulari i kërkesës autorizimi për mission.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. Kjo teknologji innovative u zbatua maximalisht në vitin 2019- 2020, 2020-2021 për shkak të situatës pandemike, duke zhvilluar mësimin on line.<br>Gjatë takimeve të zhvilluara, GVJ konstartoi se Universiteti në faqen ëeb ka të publikuara këto metoda inovative si për studentët edhe për stafin akademik dhe ndihmës akademik Ne vijim linket respektive:<br>https://ëëë.unizkm.al/posts/slug/guida-per-i-docenti?highlight=manuale%20<br>https://ëëë.unizkm.al/posts/slug/guida-per-gli-sudenti?highlight=manuale%20 |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. | GVJ konstatoi gjatë takimit me stafin akademik se institucioni dëshmon një angazhim dhe përkushtim maximal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të pare, në harmoni me objektivat dhe me strategjinë e institucionit dhe angazhimin optimal për të arritur objektivat e programit të studimit.<br>IAL ka një Regullore mbi procedurën e menaxhimit të Burimeve njerëzore, ku përcaktohen kriteret e rekrutimit dhe punësimit. Procedurat ekzekutohen nga Zyra e Burimeve Njerezore dhe bëhen publike në faqen ëeb. Shpallja përcakton kriteret për stafin që do të rekrutohet duke elenkuar elementet e domosdoshem përfshirë këtu edhe titujt /gradat e nevojshme. Procedura është e qartë dhe mjaft transparente për të gjithë.<br>*Evidenca nr 45 – Rregullore e mbi procedurat e Burimeve njerezore te UKZKM* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të | GVJ konstatoi gjatë inspektimit të infrastrukturës së institucionit konstatoi se, institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse |

| | |
|---|---|
| numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.<br>GVJ konstatoi një kabinet fizioterapie të paisur me aparatura bashkëkohore, palestra, pishina, auditore të paisura me infrastrukturën e duhur për zhvillimin e mësimit, kabineti i histologjisë, bibloteka fizike dhe on-line, zyrat e personelit dhe sekretaria mësimore me hapsira dhe mobilimin përkatës etj.<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | GVJ nga vizita në institucion vuri re hapsira të shumta për një process mësimor sa më të volitshëm si dhe hapsira jo vetëm për një mësimdhënie dhe mësimnxënie, por dhe hapsira për të kaluar në kohën e lirë midis orëve mësimore ose pas mësimit.<br>Mjediset mësimore me hapsirat të mëdha të përshtatur me numrin e studentëve si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi dhe mendon se ZKM ka hapsira mësimore si: Laboratorët, studio, kabinete, sipas natyrës specifike të programit të Fizioterapisë, të gjitha hapsirat të paisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave, objektivave të moduleve, aftësimit teorik e praktik të studentëve të fizioterapisë. Kampusi Universitar i UKZKM përmban objektet si: Ndërtesa Qendrore, Casa Rossa, kabinetet, Qendra e Rehabilitimit te Mjekesise Sportive, kalceto etj. Këto objekte janë në funksion të procesit mësimor . Infrastruktura e Kampusit është e standardeve europiane dhe investimi I institucionit është dukshëm. Sikundër gjatë vizitës dy ditore në institucion patëm mundësi të vizitonim edhe strukturën e re spitalore e cila është në fazën e saj përfundimtare.<br>*Evidenca nr.48 Bashkëlidhet Certifikata e Pronësisë së Ndërtesës QendroreEvidenca nr.48 Bashkëlidhet Certifikata e Pronësisë së Ndërtesës Qendrore*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron. | Gjatë vizitës në institucion dhe inspektimin e klasave, laboratoreve ambienteve të ndryshme të mësimit GVJ, konstatoi se studentëve dhe stafit ju vihet në dispozicion dhe përdoret Microsoft Office, softëare për të cilët zotërojnë të gjitha licencat e nevojshme.<br><br>Gjate inspektimit te infrastrukture se IAL-se, mundem te shihnim laboratorin e informatikes i cili eshte i pajisur me 48 laptop e markës Acer, të cilët janë të pajisur me procesorë i3 CPU, që të gjithë me një sistem operativ Ëindoës 10, të pajisur me licencë të lëshuar nga OVS. Gjithashtu pranë ambienteve të bibliotekës u konstatua se në dispozicion të stafit dhe studentëve janë 3 PC. |

| | |
|---|---|
| | Përdorimi kryesor i tyre është për qëllime kërkimore në një Katalog i Hapur i Hyrjes Publike (OPAC) universitare ose ato të universiteteve partnere. Në të njëjtën kohë këto PC përdoren edhe për hartimin dhe përpunimin e tezave të diplomave.<br><br>Gjithashtu për studentë dhe stafin akademik IAL-ja ka vënë në dispozicion 2 hapësira te cilat janë të pajisura me 9 dhe 5 kompjuterë me akses të hapur, të fituar nga projekti GRADUA.Portali kushtuar studentëve falas.<br>***https://unizkm.onthehub.com***<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | GVJ gjate vizitës dhe inspektimit në UZKM, konstatoi se institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron mjediset të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike, si kabineti i fizioterapisë me boxe të ndara, me aparatura bashkëkohore, me kabinet të anatomisë, fiziologjisë, pishina që qëndon gjatë gjithë vitit e ndezur me temp 32 gradë, palestra, poliambulanca, qendra e stimulimit mjekësor të avancuar,qendra e rehabilitimit sportive,ambiente argëtuese kalceto, fusha për aktivitete të ndryshme sportive.<br>ZKM siguron të gjitha hapsirat që i duhen një kampusi universitar mjekësor.<br>*Vizitë në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | GVJ gjatë inspektimit të bibliotekës konstatoi se ZKM disponon bibliotekën fizike dhe on line.Punonjëset janë vazhdimisht në ndihmë të studentëve jo vetëm duke i ndihmuar me librat që gjenden fizikisht në bibliotekë, por dhe duke marrë kërkesa të tyre për literaturën bashkëkohore, ose që nuk gjendet në fakultet për ti porositur dhe vënë në dispozicion studentëve. GVJ ne bashkëbisedim me studentët konstatoi se ata kishin lirshmëri dhe ishin të mbëeshtetur me literaturë në mënyrë të vazhdushme paradite dhe mbasdite, po kështu aksesi falas në bibliotekën on line. GVJ konstatoi se bibloteka fizike dhe on line vihej në dispozicion falas jo vetëm për studentët por dhe stafin akademik dhe ndihmës akademik në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.<br>*biblioëeb.unizkm.edu.al*<br>*Vizitë në institucion* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ konstatoi se biblioteka e ZKM ishte pagëzuar me emrin: Biblioteka e Universitetit Fr Paolo Ruatti.<br>GVJ konstatoi se biblioteka ishte e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit te diplomës Fizioterapi. Biblioteka fizike ishte e ndarë me pavione sipas diplomave. Diploma e fizioterapisë kishte një numër të madh librash në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Aktualisht bibloteka kishte rreth 17,000 vëllime(libra dhe revista në format letër. Të inventarizuara sipas standardeve të vendosura nga IFLA (Shoqata Ndërkombëtare e Biblotekave). Klasifikimi dhe katalogimi kryhet sipas skemës ndërkombëtare CDD (Deëey Decimal Classification)<br>Evidenca nr 32 – Lista e librave<br>Evidenca nr 33 – Rregullorja e Bibliotekës |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | GVJ gjatë takimit me studentët, vizitës në bibliotekë konstatoi se biblioteka funksionon sipas një rregulloreje të miratuar më parë. Konkretisht në përputhje me nenin 2 të rregullores së bibliotekës - Marrësit e shërbimeve dhe nenit 3 - Shërbimet e bibliotekës.<br>GVJ konstatoi dhe u informua se institucioni krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.<br>GVJ konstatoi që biblioteka është në dispozicion të studentëve për cdo matërial/tekst të nevojshëm që është në funksion të përftimit të njohurive për asimilimin e modulit/lëndës perkaqtese.<br>*Evidenca nr.33 Rregullorja e Bibliotekës*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike të cilat mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve dhe stafit akademik. Studentëve dhe stafit akademik u ofrohet shërbim falas në biblioteka on line që është portali: biblioëeb.unizkm.edu.al i cili komunikon me risitë dhe përditësimet e tij.<br>*Evidenca nr.33 Rregullorja e Bibliotekës, neni 3.5*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | GVJ konstatoi se Biblioteka zotëron një Rregullore mbi bazën e të cilës funksionon.<br>Për sa i përket fondit të bibliotekës ai përditësohet si nga sugjerimet e profësorëve ashtu edhe nga dhurimet. Në rastet kur teksti nuk është teksti i kërkuar dhe nuk disponohet në data bazën e bibliotekës, bëhet kërkimi i tij nëpërmjet Document Delivery. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | GVJ konstatoi se cdo fillim i vitit të ri akademik biblioteka bën nje kontroll për të kontrolluar librat aktualë, botimet e përditësuara si edhe librat që janë përdorur ndër vite dhe që duhet të zëvendësohen.<br>*Evidenca nr.33 Rregullorja e Bibliotekës, neni 3.6*<br>*Evidenca nr.32 Lista e librave.*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | GVJ gjatë vizitës në institucion, në bibliotekë, në takimin me studentët, dhe stafin akademik konstatoi se, biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. GVJ konstatoi se punonjësit e biblotekës ishin në dispozicion të studentëve gjatë kohës për studim dhe kërkim shkencor, gjithashtu biblioteka funksiononte me një orar të shërbimeve si mëposhtë: shërbim konsultimi, marrje dhe kthimi I librave, shërbim i dokumenteve të dorëzimit etj.<br>Ajo cka u vu re nga GVJ gjatë vizitës në IAL është se salla e leximit në dispozicion të studentëve është e hapur nga e hëna – deri të dielën. Gjithashtu është e hapur dhe gjatë ditëve festive zyrtare, përveç festave fetare.<br>*Evidenca nr.33 Rregullorja e Bibliotekës*<br>*Vizitë në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | GVJ konstatoi se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin të quajtur UniMS (Sistemi i Menaxhimit të Universitetit) që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Ky system bën të mundur dixhitalizimin e informacioneve dhe të dhënave të prodhuara gjatë proceseve të punës mësimore dhe administrative në Universitet.<br>*Evidenca 37 – Rregullorja e përdorimit të pajisjeve informatike* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe | GVJ nga informacioni i marrë në takimin me punonjësit e IT, dhe raporti i RVB, konstatoi se Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, ruan të dhënat e studentëve që nga rregjistrimi deri në diplomim. Të |

| | |
|---|---|
| partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | dhëna të kërkuara nga Rregjistri Kryesor i Studentëve sipas udhëzimeve të Ministrisë. Këto të dhëna ruhen në formatin në letër dhe jo letër për të mos gabuar.Kjo bazë të dhënash përfaqëson në mënyrë dixhitale të gjithë informacionet në formatin në letër dhe jo letër, gjithashtu skanimi i dokumentave si dhe kalimi në formatin PDF.<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstatoi se në institucion ekziston një system i menaxhimit, ERP (Enterprise Resource Planning), i cili është një softëear dedikuar për informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Sistemi është zhvilluar në universitet, dhe siguron bashkërendimin e proceseve të punës sipas rregullave.<br>https://ëëë.unizkm.al/posts/slug/guida-per-i-docenti?highlight=manuale%20<br>https://ëëë.unizkm.al/posts/slug/guida-per-gli-sudenti?highlight=manuale%20 |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | GVJ gjatë takimit me sekretarinë mësimore, studentët, stafin konstatoi, se IAL disponon tre sisteme si :<br>- UniMS (Sistemi i Menaxhimit të Universitetit)<br>- UniSATI<br>- dhe Portali i studentit<br>të cilët bëjnë të mundur që cdo student dhe/ose staf akademik të aksesoj nëpermjet userit dhe passëordit individual. Të mund të shohi dhe/ose shkarkoj cdo informaion lidhur me karierën e tij studentore.<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Gjate takimeve në institucion GVJ konstatoi se në IAL dispon një softëer ERP i cili është i përbërë nga:<br>-Portali i Studentëve: Studentët mund të identifikohen me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e tyre privat, ose me llogaritë e Google @stud.unizkm.al<br>-Portali i Pedagogëve: Portali shërben si depo e materialit mësimor për pedagogun për lëndën<br>-Google Classroom: Platforma e dedikuar për mësimdhënie online<br>-Portali i Pranimeve: Portali i Pranimeve u shërben kandidatëve për studentë të ardhshëm si pike informacioni, regjistrimi për provimet e pranimit, shfaqjeje të pikëvedhe pozicionit të tyre në renditje.<br>-Portali i Bibliotekës: Biblio ëeb është një Katalog i Hapur i Hyrjes Publike (OPAC), një përfaqësim dixhital i bibliotekës Fratel Paolo Ruatti.<br>-Real Time Classroom –Klasa në kohë reale: Ky modul është i lidhur me TV Signage që ndodhen në secilën ndërtesë dhe japin në kohë reale zënien e auditorëve, të pedagogëve, të programit të studimit, të lëndës dhe të klasës. Konstatim ne vizite<br>-Mailing Lists/Google Groups: për çdo program studimi, ka nje grup qe shërben si një listë e marrësve të komunikimeve me postë elektronike si për shembull, group.fisioterapia1@stud.unizkm.al, ashtu edhe si një“forum" për shkëmbimin e informacioneve dhe të komunikimeve.<br><br>*Faqe ëeb të https://ëëë.unizkm.al/ gjendet secili portal i larte permendur.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Vizitë në institucion* | | | |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se të gjitha informacionet mund të gjenden në faqen e internetit unizkm.al, në seksionet e dedikuara, të disponueshme në tri gjuhë: shqip, italisht, anglisht.<br><br>*Faqe ëeb të https://ëëë.* unizkm.al<br>*Vizitë në institucion* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Mbështetur në RVB dhe statutin e Institucionit vihet re se se institucioni harton dhe mbikqyr një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.<br>*Evidenca Nr.9 Statuti Neni 6,9,33* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. | Bazuar në në RVB, statutin e institucionit, vizitës në institucion u konstatua se existon një plan buxhet me zëra të ndryshëm i miratuar nga bordi, mbi financimin për personelin mësimor, ndihmës mësimor, administratë, për kërkimin shkencor, bursa për studentët sipas meritë preferencës; shpenzimet operative materialet e konsumit, higjenën, sigurinë institucionale, mirëmbajtjen, shpenzimet komunale,rinovimi i laboratoreve të fizioterapisë, pasurimi i bibliotekës; shpenzimet për mbështetjen e praktikave në Shqipëri dhe në Itali etj.<br>*Evidenca Nr.9 Statuti Neni 6,9,33*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | GVJ bazuar në RVB , bazuar në takimin me koordinatoren e programit, bazuar në statutin e institucionit vren se Institucioni përgatit raporte financiare mbi baza vjetore, bën auditim të brendshëm dhe të jashtëm vjetor e cila përfshin bilancin dhe pasqyrën e të ardhurave sipas zërave si: tarifat e universitetit, tarifat për shërbimet e tjera të secretaries si dhe zërat e shpenzimeve të përshkruar te "Kriteri 2".<br>*Evidenca Nr.9 Statuti Neni 6,9,33*<br>*Vizita në institucion* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | GVJ sic theksoi dhe më lartë konstatoi se në fund të çdo cikli studimi tre vjeçar , institucioni analizon dhe dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon buxhetin për vitin e ardhshëm, duke bërë një planifikim afat gjatë, për një periudhë që përfshin tre vitet në vijim. Ky planifikim shërben për të patur një mbarëvajtje të mirë të programit të studimit.<br>*Evidenca Nr.9 Statuti*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | Bazuar në RVB, evidencat e vëna në dispozicion nga institucioni si dhe gjatë takimeve në institucion konstatuam se institucioni ka një një raportit financiar të detajuar sipas zërave të ndryshëm( plan financiar për: stafin akademik, ndihmës akademik, sekretari, bibliotekë, kabinete, administratë, siguracione të institucionit, programet e studimit, kërkimin shkencor) duke garantuar kështu cilësinë e veprimtarisë aktuale të programeve mësimore si duke e përmirësuar gjithmonë atë në përputhje me legjislacionin shqipëtar dhe marrveshjeve të bashkëpunimit me Universitetin Tor Vegata të Romës.<br>*Evidenca nr3 Marrveshje në kuadër për bashkëpunim për veprimtaritë formuese të UKZKM &Tor Vegata Romë*<br>*Evidenca Nr.9 Statuti*<br>*Vizita në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | GVJ gjatë bashkëbisedimi me dekanin e Fakultetit, studentët, koordinatorin e programit, sekretarinë mësimore, konstatoi se ky institucion harton politika dhe procedura të sakta gjatë vitit akademik për studentët nga procesi I pranimit në këtë institucion deri në përfundim të studimeve. Bazuar këto politika në vendimet, udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Rinisë dhe Sporteve të vendit tonë , si dhe legjislacionit Italian për shkak të bashkëpunimit me Universitetin Tor Vergata të Romës . Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" bazuar në udhëzimet përkatëse të MASR si për cdo program studimi edhe për Programin e Studimit Bachelor në "Fizioterapi", pranimi i studentëve bëhet në bazë të një numër kuotash të propozuara nga dekanati i Fakultetit të Mjekësisë, të miratuara nga Senati akademik i institucionit dhe më pas të aprovuara dhe nga MASR. Po kështu krahas kuotave Senati i UKZKM miraton edhe kriteret e pranimit. I gjithë ky informacion përcillet në MASR si dhe publikohen në faqen e internetit *në faqen zyrtare të Universitetit* ***www.unizkm.al si*** *dhe* në portalin https://ualbania.al/, ky informacion ruhet edhe në formë shkresore(në institucion dhe në MARS).<br><br>Në kuotat e pranimit, si për cdo IAL dhe në UKZKM bazuar në udhëzimet përkatëse të MARS, ka kuota të vecanta për: shtetas të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Bosnjë– Hercegovinës. Studentët të cilët regjistrohen për herë të parë në programin e studimit të Diplomës Bachelor në Fizioterapi, marrin një bursë studimi deri në 30% të pagesës vjetore në vitin e parë.<br>Procedura të regjistrimit dhe afatet përkatëse (me raunde), përcaktohen nga dekrete e vendime të nxjerra çdo vit nga Ministria Shqiptare e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, rankimimi I studentëve bëhet në bazë të notës mesatare të Maturës shtetërore.<br>Procesi i rregjistrimit bëhet on line në portalin e studentit në e- Albania dhe më pas fizikisht pranë sekretarisë mësimore.<br>Institucioni kishte në përdorim edhe rregjistrin e studentit I cili dokumenton nga procesi I rregjistrimit, deri në përfundim të studimeve apo dhe crregjistrimin për at student që dëshirojnë të crregjistrohen.<br>GVJ mendon se ky institucion zbaton politika dhe procedura që mbulojnë studentët nga fillimi I studimeve deri në mbarim të tyre, në përputhje me legjislacionet në fuqi.<br>*https://unizkm.al/posts/slug/kriteret-e-pranimit-ne-programet-e-ciklit-te-i-re-dhe-ne-ato-te-integruara-te-ciklit-te-dyte-per-vitin-akademik-2020-2021?highlight=kriteret%20e%20pranimit*<br>*https://ualbania.al/*<br>*Evidenca nr.49 Letra nr. 61, e datës 11/02/2019 – Informacion mbi kriteret e pranimit në programet e studimit të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", për vitin akademik 2020-2021.*<br>*Evidenca nr.50 Kuotat në dispozicion në ciklin e parë dhe të dytë, viti akademik 2020-2021* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr.51 Shpallje e thirrjes për pranime që u drejtohet shtetasve shqiptarë për vitin akademik 20 20-2021*<br>*Evidenca nr.52 Shpallje e thirrjes për pranime që u drejtohet shtetasve të huaj për vitin akademik 2020-2021* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore GVJ vuri re se ky institucion siguron barazinë për të gjithë kandidatët për tu rregjistruar në diplomën e fizioterapisë. Në takimin me sekretarinë konstatuam se ekzistonin rregjistra të cilat tregonin të gjithë praktikën e rregjistrimit apo të crregjistrimit të studentëve fitues sipas kritereve dhe portalit të studentit, pa bërë dallime se kujt i përkisnin këto kuota (student shqipëtar, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Bosnjë– Hercegovinës ).Kjo tregon barazi institucionale për cdo student.<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku kriteret si më poshtë: procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Për t'u regjistruar dhe për të marrë pjesë në provimin e pranimit, kandidatët që kanë marrë Diplomën e Shkollës së Mesme jashtë vendit duhet të regjistrohen *online* në portalin universitar: http://admissions.unizkm.al/#/.<br>GVJ gjatë vizitës dy ditore konstatoi se regjistrimi për kandidatët e huaj, kryhet me rezervë, deri në dorëzimin e lejes së qëndrimit edhe i nënshtrohet dorëzimit të dokumentit të njësimit të çertificates së Diplomës së Maturës, të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore të Republikës së Shqipërisë. Universiteti ofron mbështetje duke publikuar në faqen zyrtare të internetit të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje mbi hapat që duhet të ndiqen për të përftuar këto dokumente të cilat janë të aksesushme lehtësisht nga të gjithë që janë të interesuar. Po kështu krahas kritereve dhe hapave të rregjistrimit bëhet dhe një test vlerësues paraprak për të gjithë studentët e interesuar për të bërë studimet pranë UKZKM.<br>Testim për kandidatët shqipëtar dhe kandidatët nga vendet jo anëtare të Bashkimit Europian:<br>*Test me shkrim në gjuhën italiane:*<br>*Test për të vlerësuar njohuritë e kandidatëve në Shkencat:*<br>*Biologji, Fizikë, Kimi dheMatematikë - 30 pikë;*<br>*Test me shkrim mbi njohjen e gjuhës italiane - 20 pikë;*<br>*Vlerësimi I notës mesatare të shkollës së mesme - 30 pikë.*<br>Testim për kandidatët që vijnë nga vendet e BE-së:<br>*Test me shkrim në gjuhën italiane;*<br>*Test për të vlerësuar njohuritë e kandidatëve në Shkencat: Biologji, Fizikë, Kimi dhe Matematikë - 60 pikë;*<br>*Vlerësimi i notës mesatare të shkollës së mesme - 30 pikë.*<br>Renditja dhe përcaktimi i fituesve do të kryhet mbi bazën e rezultateve përfundimtare individuale, duke ndjekur rendin zbritës. Rezultatet afishohen në faqen zyrtare të UZKM, *ëëë.unizkm.al.*<br><br>[83] *https://unizkm.al/posts/slug/lista-e-renditjes-se-aplikanteve-te-raundit-te-pare- 2020-2021?highlight=listat%20e%20renditjes* |

| | |
|---|---|
| | [84]*https://unizkm.al/uploads/media/file/0001/01/dbe3be058b6fde63172e0bd05cec 6c667 f1da3de.pdf*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. | GVJ u informua sic kemi përmendur dhe në kriteret e mësipërme se Senati Akademik i UKZKM cdo vit miraton kuotat dhe kriteret e pranimit si dhe procedurën e rekrutimit dhe rregjistrimit të studentëve. Kuotat dhe kriteret per ciklin e parë të studimeve publikohen cdo vit në faqen ëeb te IAL-së.<br>*Evidenca nr. 50 Kuotat ne dispozicion ne ciklin e pare dhe te dyte per vitin akademik 2020-21*<br>*Evidenca nr.52 Shpallje e thirrjes për pranime që u drejtohet shtetasve të huaj për vitin akademik 2020-2021*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 5.** Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore u informua se procesi i pranimeve në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" organizohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Procesi i pranimeve bëhet në bazë të kuotave dhe kritereve të pranimit të miratuara më parë nga senati i institucionit dhe MARS. Në kuotat e pranimit sipas udhëzimeve që vijnë nga MARS, ka vende -kuota jo vetëm për studentët brenda dhe jashtë vendit me maturë shtetërore, por edhe kuota për transferime. Transferime në programin e studimit Bachelor në Fizioterapi u lejohet studentëve që vijnë nga programe studimi të të njëjtit cikël dhe fushës së studimit të universiteteve publike, jo publike të vendit ose të huaja.<br><br>Procedurat dhe afatet kohore për dorëzimin e kërkesës për transferimin e studimeve në UKZKM gjithashtu përcaktohen me udhëzime të vecanta të MARS. Pas shpalljes së Dekretit Ministror, institucioni publikon rregulloren për transferimin e studimeve në faqen zyrtare *www.unizkm.al.*(Afatet, kriteret dhe procedurat e transferimit).<br>*Evidence nr.26 Regullore për transferimin e studimeve në UKZKM nr,291*<br>*Evidenca nr. 50 Kuotat ne dispozicion ne ciklin e pare dhe te dyte per vitin akademik 2020-21* |
| **Kriteri 6.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | GVJ bazuar në RVB-në, vizitën në institucion u informua se se UZKM, përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni orienton publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Këto informacione janë të publikuara në faqen zyrtare të UKZKM për të gjithë ata që janë të interesuar për këtë universitet..<br><br>Për sa më sipër ndër politikat e marketingut dhe transparencës me publikun ndiqen edhe këto procedura: organizimi i Diteve te Hapura (Open Day), për kandidatet e huaj dhe shqiptar pjesëmarrja në veprimtari si "Ditët e informacionit për maturantët. takime të planifikuara dhe të organizuara në Shkollat e Mesme në Shqipëri dhe në rajon, pjesëmarrja në panaire të Arsimit të Lartë, të organizuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë<br><br>*Evidenca nr.52 Shpallje e thirrjes për pranime që u drejtohet shtetasve të huaj për vitin akademik 2020-2021* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Evidenca nr.54 Politika e marketingut format e tij dhe transaporenca me publikun*<br>*Vizita në institucion* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Bazuar në takimet me studentët, sekretarin mësimore, stafin akademik si dhe koordinatorin e programit të Fizioterapisë rezulton që në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin vihet në dispozicion nje informacion i plotë dhe i hollësishëm nga Zyra e Pranimeve. Përvec kësaj me studentët e regjistruar në vitin e parë për t'i informuar ata në lidhje me planin e studimit, me provimet përgatitore, me rregulloret e programit të studimit, me rëndësinë e përdorimit të portalit të studentëve, me procedurat e nevojshme për përparimin e tyre dhe me kalimin nga një vit në vitin pasardhës, Koordinatori së bashku me sekretarinë mësimore të programit të studimit zhvillojnë një takim informues.<br>Për sa i përket problematikave të studentëve Koordiantori na informoi se gjatë vitit akademik, organizohen takime mujore me studentët.<br>*https://portal.unizkm.al/*<br>*Evidenca nr.23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca nr 26 Evidence nr.26 Regullore për transferimin e studimeve në UKZKM n,291*<br>*Evidenca nr 43: Rregullore mbi veprimtarinë e sekretarisë mësimore*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | GVJ gjatë vizitës në institucion u informua nga Koordinatori dhe sekretaria mësimore e programit te studimit se, për sa i përket procesit të transferimit të studimeve dhe procedurave për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, respektohen dekretet/rregulloret ministrore (MASR), si edhe rregulloret e brendëshme të nënshkruara nga Rektori.<br>Po kështu nga takimi me sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se institucioni informon rregullisht studentët për kriteret dhe procedurat për verifikimin e njohurive dhe aftësive të studentit gjatë programit të studimit.<br>*Evidenca nr.55Regullore për regjistrim në një program të dytë studimi, n 290*<br>*Evidenca nr.26 Regullore për transferimin e studimeve në UKZKM n,291* |

| | |
|---|---|
| | *Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | GVJ gjatë takimit me studentët, sekretarinë mësimore të programit të Fizioterapisë dhe koordinatorin e Programit të Studimit konstatoi se: institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme në formë elektronike në faqen zyrtare të institucionit, si dhe në takimet që bëhen në fillim të vitit akademik me koordinatoren e programit, e cila krahas prezantimit të infrastrukturës , ju bën me dije edhe mënyrën e vlerësimit të tyre gjatë viteve akademike nga fillimi i studimeve deri në mbarimin e programit të studimeve.<br>Po ashtu studentët njihen nga pedagogët e lëndëve përkatëse në orët e para të mësimit, me planin mësimorë, syllabuset e lëndëve, në të cilat janë të pasqyruara : temat e lexioneve , literaturën që duhet për këtë lëndë ,mënyrën e vlerësimit të dijeve, detyrimet që ka studenti për procesin mësimor (frekuentim lexione, seminare, laborator, praktika lëndore dhe praktika klinike ) etj.<br>Lendët sipas planit mësimor ndahen në lëndët semestrale ose vjetore dhe për vlerësimin e studentëve exzistojneë tre sezone normale(sezoni i dimrit, sezoni i verës dhe sezoni i vjeshtës).<br>Studentët paraprakisht informohen për kalendarin e provimeve, i cili afishohet në këndin e njoftimeve si dhenga sekretaria publikohen në faqen zyrtare të institucionit.<br>Kalendari i provimit ka të specifikuara : data e provimeve, ora e provimeve, modaliteti përkatës dhe komisioni i provimit.<br>Studenti pas vlerësimit nga komisioni përkatës, ka të drejtë të kontestoj notën në qoftë se nuk është dakort me vlerësimin, dhe pas ballafaqimit me provimin në prani të komisionit të vlerësimit firmos në process verbal që është dakort ose jo me vlerësimin.<br>*Ref. Evidenca nr.14 Plani I Studimit. Syllabusi i lëndëve*<br>*Evidenca nr.23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca nr 43: Rregullore mbi veprimtarinë e sekretarisë mësimore*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | GVJ, gjatë takimit me koordinatorin e programit të studimit, dhe sekretarinë mësimore, u informua që të gjithë studentëve që kanë përfunduar të gjitha detyrimet akademike të tre viteve dhe janë gati të diplomohen u sigurohet i gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me përgatitjen e punimit të diplomës.<br>Pedagogët udhëheqës orientojne dhe udhëzojnë për mënyrën e zhvillimit të temës së diplomës të gjithë studentët përkatës.<br>Gjithashtu, rezultoi gjate takimit me stafin e bibliotekës se të gjitha temat e punuara më parë janë në dispozicion të studentëve dhe të ruajtura fizikisht në bibliotekë si dhe studentët ndihmohen dhe orientohen nga stafi i bibliotekës për literaturën apo vënien në dispozicion të komjuterave për të punuar. |

| | |
|---|---|
| | Institucioni në mbështetje të përgatitjes së procedurave të diplomimit dhe mbrojtes së diplomës organizon javën e konsultimeve sa i përket studentëve që do të diplomohen.<br>*Evidenca nr.27 Rregullore e temës së diplomës*<br>*Evidence nr.33 Rregullore e bibliotekës*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimit me koordinatorin e programit të Fizioterapisë, sekretarinë mësimore përkatëse u informua se plotëson formularin "Shprehje e interesit". Gjatë procesit të pranimit, kandidatët që kanë plotësuar formularin 'Shprehje e Interesit' do të marrin nëpërmjet postës elektronike udhëzimet dhe informacione të përditësuara në lidhje me procedurat e pranimit në UKZKM.<br>Gjithashtu u informuam se institucioni organizon çdo vit ditë të hapura (open day) për studentët e interesuar, ata paraqiten me të gjitha mundësitë që ofron universiteti dhe u prezantojnë atyre mjediset e universitetit, programet.<br>*Evidenca nr.56 Shprehje interesi.*<br>*Evidenca nr.23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Vizitë në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | GVJ gjatë vizitës në institucion ne takimin me koordinatoren eprogramit u informua se institucioni cdo fund viti organizon aktivitetin e ditëve te hapura (open day) për informimin e maturantëve që dëshirojnë të ndjekin studimet në UKZKM.<br>Koordinatori mësimor zhvillon një takim për qëllime informimi me studentët që regjistrohen përherë të parë, gjatë të cilit i informon ata në mënyrë të hollësishme mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, etj<br>*Evidenca nr.23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca nr.54 Politika e marketingut format e tij dhe transaporenca me publikun*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, | Gjatë këtij takimi GVJ u informua, ashtu si dhe bazuar në RVB e përgatitur se, studentëve ju vihet gjithmonë në dispozicion për dhënie informacionesh ose sqarimesh në lidhje me programin e studimit.<br>Studentet informohen edhe nga: |

| | |
|---|---|
| përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | ➢ sekretaria mësimore<br>➢ zyra e pranimeve;<br>➢Në mjediset e përcaktuara nga universiteti, publikohen në format letre informacione të tilla si: orët e mësimit, datat e provimeve dhe njoftime të ndryshme.<br>➢Në faqen ëeb te IAL-se;<br>➢Nëpërmjet Rregulloreve Mësimore të programit të studimit të Diplomës.<br>➢Portali i studentëve<br><br>*Evidenca nr 13 Rregullore mësimore për programin e studimit në Fizioterapi*<br>*Evidenca nr 43. Rregullore mbi veprimtarine e sekretarisë mësimore*<br>*Evidenca nr 59: Rregullore e sekretarisë për rregjistrimin e studentëve dhe rregjistrin bazë.*<br>*http://unims.unizkm.edu.al/*<br>*https://portal.unizkm.al/*<br>*https://ëëë.unizkm.al/study/faculty/facolta-di-medicina* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. | GVJ gjatë takimit me punonjësit e zyrës së karrierës u informua se institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. UKZKM ka marrveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme shtetërore dhe private , ku studentët kryejnë praktikat klinke, nga këto institucione në bashkëpunim me zyrën e Këshillimit të Karrierës shprehin kërkesat për vende pune dhe institucioni i orienton studentët në këtë treg. Po ashtu studentët në mënyrë të vazhdueshme edhe kur mbarojnë ruajnë kontaktet me institucionin me anë të e-maileve, faqes zyrtare të institucionit, apo Fb të institucionit informojnë për punësimin e tyre ,si dhe kërkesa që mund të ketë në vendet ku janë të punësuar, për orientimin e studentëve pasardhës në tregun e punës me ndërmjetësimin e Zyrës së Karrierës.<br><br>Zyra e Karrierës u dërgon të diplomuarve me anën e postës elektronike kërkesat që ka për tregun e punës dhe ofron mbështetjen e saj për mënyrën se si të paraqesin një kërkesë për një vend pune, si të shkruajnë një Curriculum Vitae (CV) dhe si të përgatitet për një intervistë pune. Institucioni zotëron në formë elektronike një tabelë ku ruhen të dhënat e studentëve nga fillimi, mbarimi i studimeve dhe deri në punësimin e studentëve si dhe një rregjistër me këto të dhëna .<br>GVJ mendon se institucioni motivon, mbështet dhe orienton studentët në tregun e punës.<br>*Evidenca nr. 9.Statuti*<br>*Evidenca nr.12. Rregullore e fakultetit*<br>*Evidenca nr 43. Rregullore mbi veprimtarine e sekretarisë mësimore*<br>*Evidenca nr.23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i | Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ky informacion merret nga koordinatori i programit mësimor, sekretaria mësimore, Zyra e |

| | |
|---|---|
| përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Orientimit të Karrierës ,si dhe on line sipas linqeve të paraqitura , studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.<br>*Evidenca nr. 9.Statuti*<br>*Evidenca nr.12. Rregullore e fakultetit*<br>*Evidenca nr 43. Rregullore mbi veprimtarine e sekretarisë mësimore*<br>*Evidenca nr.23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Vizitë në institucion*<br>*http://unims.unizkm.edu.al/*<br>*https://portal.unizkm.al/*<br>*https://ëëë.unizkm.al/study/faculty/facolta-di-medicina* |
| **Kriteri 5** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. | GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe takimet me studentët e Fizioterapisë, konstatoi se studentët informohen me anë të sistemit të menaxhimit të brendshëm, nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit, portalit të studentit *http://unims.unizkm.edu.al/*, *https://portal.unizkm.al/* për programin e studimit edhe në distancë<br>Sistemi UniMS bën të mundur që studentët të kenë akces falas në faqen zyrtare të institucionit, në kohë reale për programin mësimor, vlerësimet, detyrimet etj<br>Gjithashtu Universiteti disponon një softëare për menaxhim e mbarvajtjen e programit të studimit. Ku i gjithë informacioni në letër ngarkohet dhe ruhet në mënyrë dixhitale në sistem.<br>Menaxhimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Fizioterapi bëhet jo vetëm me anë të rregjistrave të përgjithshëm të studentit, rregjistri i rezultateve akademiketë studentëve ku dokumentohet i gjithë aktiviteti akademik i cdo studenti nga hyrja në këtë fakultet dhe deri në përfundim të studimeve.<br>Por menaxhimi i programit të studimit është dhe në formën elektronike me anë të Sistemit UniMS i cili është i aksesushëm nga studenti në cdo kohë dhe në distancë.<br>Sistemi UniMS bën të mundur menaxhimin e:<br>- Karrierës së mësimdhënies së studentit;<br>- Frekuentimit të e lëndëve provimet, notat;<br>- Praktikës profesionale;<br>- Planit të studimit: lëndët, kalimin, frekuentimin, numrin e provimeve, kalimin e provimit, etj.<br>*http://unims.unizkm.edu.al/*<br>*https://portal.unizkm.al/*<br>*Evidence nr 34 Rregullore e përdorimit te pajisjeve informatike*<br>*Evidenca nr 43. Rregullore mbi veprimtarine e sekretarisë mësimore*<br>*Evidenca nr.57 Modeli i regjistrave të rezultateve akademike.*<br>*Evidenca nr.58 Regjistri i lendes*<br>*Evidenca nr.41 Libreza e praktikes*<br><br>*Evidenca nr.60 Regjistri i Përgjithshëm i studentit.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | | | X |
|---|---|---|---|---|

| Standardi V.4<br>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. | GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore ju vendos në dispozicion rregjistrat e studentëve të degës Fizioterapi në vite të ndryshme.<br><br>Rregjistri i përgjithsëm i studentëve në të cilin janë të hedhura të dhënat e studentëve nga momenti i hyrjes në këtë fakultet, deri në përfundim të studimeve , ku në fund shkruhet nr i Amzës dhe studenti firmos kur tërheq diplomën.<br><br>Rregjistri me të dhënat e studentëve të crregjistruar të cilët firmosin në fund dhe arsyen e crregjistrimit.<br><br>Rregjistri i vlerësimit të studentëve sipas lëndëve përkatëse deri në mbylljen e të gjitha detyrimeve akademike të studentëve.<br><br>Institucioni me anë të këtyre rregjistrave vjetore të studentëve , bën një përpunim statistikor mbi numrin e studentëve që mbarojnë , diplomohen në këtë program studimi. Stdentë që transferohen, studentët që nuk përmbyllin detyrimet akademike.<br><br>Po kështu GVJ konstatoi se cdo vit, Zyra e Statistikave disponon dhe përpunon të dhëna për numrin e të gjithë studentëve dhe të diplomuarve në formë elektronike, jo vetëm për Programin e Studimit të Diplomës Bachelor në Fizioterapi, por edhe për secilin program studimi tjetër .<br><br>*Evidenca nr.57 Modeli i regjistrave të rezultateve akademike.*<br><br>*Evidenca nr.59 Bashkëlidhet Rregullorja e Sekretarisë për regjistrimin dhe për plotësimin e regjistrave bazë."*<br><br>*Evidenca nr.60 Regjistri i Përgjithshëm i studentit.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | GVJ gjatë takimit me Sekretarinë Mësimore ju vunë në dispozicion Regjistri i Përgjithshëm i studentit, regjistri i rezultateve akademike të studentëve. Këtë informacion e disponon edhe Zyra e Statistikave e cila në fund të cdo viti akademik bën përpunimin ststistikor të studentëve të ciklit të parë Bachelor në Fizioterapi mbi: numrin e studentëve të regjistruar ndër vite, nr e studentëve që tërhiqen nga programi, largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.<br><br>Sekretaria mësimore dhe zyra e Statistikave në bashkëpunim me njëra-tjetrën krijojnë një tabelë me të dhënat e mëposhtëme: numrin e |

| | |
|---|---|
| | studentëve të regjistruar, studentët e tërhequr, studentët e diplomuar, etj<br><br>Ky Infomacioni është I ruajtur jo vetëm në formë shkresore, por dhe në formë elektronike dhe i ofrohet të interesuarve nëpërmjet faqes UX të aplikacionit UniMS.<br><br>*Evidenca nr.59 Bashkëlidhet Rregullorja e Sekretarisë për regjistrimin dhe për plotësimin e regjistrave bazë."*<br><br>*Evidenca nr.60 Regjistri i Përgjithshëm i studentit.*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. | Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të UKZKM-së, GVJ konstatoi se institucioni disponon rregjistrat sipas viteve akademike nga viti i parë deri në përfundim të studimeve. Në këto rregjistra hidhen të gjitha rezultatet e lëndëve të integruara, si dhe të moduleve të ndryshme. Përvec rregjistrit në formë letre, të gjitha të dhënat e rregjistrave hidhen dhe në formë elektronike.<br>*Evidenca nr.57 Modeli i regjistrave të rezultateve akademike.*<br><br>*Evidenca nr.59 Bashkëlidhet Rregullorja e Sekretarisë për regjistrimin dhe për plotësimin e regjistrave bazë."*<br><br>*Evidenca nr.60 Regjistri i Përgjithshëm i studentit*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | GVJ konstatoi se institucioni disponon të gjitha të dhënat statistikore të studentëve, të cilat menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Nëse nevojitet këto të dhëna mund të përpunohet duke integruar bazën e të dhënave me Poëer BI (produkt i Microsoft për Inteligjencën e Biznesit - Business Intelligence). Zyra e Orientimit të Karrierës përditëson bazën e të dhënave e cila i vihet në dispozicion Zyrës së statistikave.<br>*Evidenca nr. 9.Statuti*<br>*Evidenca nr.34. Rregullorja e përdorimit të paisjeve informatike*<br>*Evidenca nr.64. Rrregullore mbi funksionin e vlerësimit të njësisë së cilësisë*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | GVJ në takim me zyrën e karrierës, rezulton se kjo zyrë harton raporte mbi shkallën e punesimit të të diplomuarve. Gjatë vizitës ne u informuam se kjo zyrë mban lidhje të vazhdueshme me studentët edhe pas diplomimit me anë të Fb të institucionit, mjeteve të ndryshme elektronike, sistemit të ALUMNI-it dhe informacioni i dërgohet zyrës së karrierës për tu lidhur për të bërë të mundur orientimin për punësimin e tyre. Gjithashtu u konstatua se institucioni mban informacion për cdo vit për studentët që diplomohen. Psh vitin e kaluar janë diplomuar 57 studentë de aktualisht janë 17 student në master.<br>*Vizitë në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.5<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | GVJ gjatë takimit me studentët e fizioterapisë konstatoi se IAL-ja parashikon përfshirjen dhe angazhimin dhe përfaqësimin e tyre në organet vendimmarrëse të Universitetit bazuar në Regulloren për zgjedhjet studentore, statut, ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 etj<br>IAL bën zgjedhjet studnetore cdo 2 vite në të cilat zgjedh përfaqësite në:<br>- Senatit Akademik;<br>- Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë;<br>- Këshillin Kombëtar Studentor;<br><br>Studentët marrin pjesë në vlerësimin e procesit mësimor, duke plotësuar në mënyrë elektronike formularët për vlerësimin e programit të studimit të tyre, për pedagogët, infrastrukturën, etj, ku shprehin qartë dhe sygjerimet e tyre. Ky pyetësor plotësohet para provimeve përkatse, për të qenë mendimet dhe sygjerimet sa më reale.<br><br>*Evidenca nr.9 Statuti, neni 44*<br>*Evidenca nr. 23.Detyrat e koordinatorit mësimor*<br>*Evidence nr. 29/1; 29/2 Model pyetësori*<br><br>*Evidenca nr 30 Perceptimi i studenteve kundrejt veprimtarise mesimore*<br><br>*Evidenca nr.61 Regullorja e Zgjedhjes së Studentëve, art 14*<br><br>*Evidenca nr.64. Rrregullore mbi funksionin e vlerësimit të njësisë së cilësisë* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | GVJ konstatoi se studentëve u garantohet pjesëmarrja në organe dhe /ose këshilla sikurse janë Senati Akademik, Këshilli Kombetar Studentor etj<br><br>Mendimet e tyre lidhur me procesin akademik janë të matshme me anë të pyetësorëve të ndryshëm në formë elektronike, të cilët plotësohen para provimeve dhe janë anonim.Studentët nëpërmjet këtyre pyetësorve shprehin mendimet për pedagogët, kabinetet, infrastrukturën, programet etj.<br>*Evidence nr. 29/1; 29/2 Model pyetësori*<br><br>*Evidenca nr. 30 Perceptimi i studenteve kundrejt veprimtarisë mësimore* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr. 61 Regullorja e Zgjedhjes së Studentëve, art 14* |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | GVJ konstatoi se në zbatim të VKM 29, 10/09/2018, të Arsimit të Lartë mbi ngarkesën mësimore të stafit pedagogjik dhe ngarkesa studentore në auditor dhe ngarkesa individuale e studentëve, institucioni e merr në konsideratë, që gjatë hartimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, bën të mundur eleminimin e procedurave burokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen, ekuivalentimin e studimeve të plota apo të pjesshme të realizuara më parë nga studentët.<br>Po kështu GVJ konstatoi se ekziston ende vështirësia e një mbingarkese për studentët, në orët e leksioneve në auditor, e cila vjen për shkak të ofrimit të mësimdhënies nga pedagogë italianë të cilët vijnë për periudha të shkurtra kohore, në përputhje me marrveshjen e bashkëpunimit me Universitetin e Tor Vergatës, Romë.<br>*Evidenca nr.2. VKM 670 , datë 28/09/2011, pika 3*<br>*Evidence nr.3. Marrveshja kuadër për bashkëpunim për veprimtaritë formuese të UKZKM &Tor Vegata*<br>*Evidenca nr 13 Rregullorja e programit te studimit* |
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Në takimin me koordinatorin e programit u konstatua se në fund të cdo semestri ose para sezonit të provimeve organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për cdo modulë për programin e studimit. Gjatë takimeve me koordinatorin studntët përvec problematikave që hasin, mund të shprehen edhe për idetë dhe sugjerimet e tyre për module specifike.<br>*Evidence nr. 29/1; 29/2 Model pyetësori*<br>*Evidenca nr. 30 Perceptimi i studentëve kundrejt veprimtarisë mësimore*<br>*Evidenca 23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca 62/1;62/2 Modeli i pyetesorit* |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | GVJ gjatë takimit me koordinatoren e programit konstatoi se në UKZKM studenti ka të drejte apelojë vlerësimin në rast se mendon se kundrej tij janë shkelur rregullat dhe është bërë një vlerësim i padrejtë. Në rast se studenti ka të drejtë të kundërshtojë rezultatin në prani të komisionit i jepen sqarimeët e nevojshme lidhur me këtë vlerësim.<br>*Evidenca 23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca 38 Rregullorja e provimeve*<br>*Evidenca 40 Formulari i ankimimit*<br>*Vizita në institucion* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi V.6**

| **Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe bazuar në RVB rezultoi se IAL ka zyra si:<br>- Sekretaria Mësimore<br>- Zyra Informatike<br>- Biblioteka<br>- Zyra e Këshillimit te Karrierës<br>të cilat janë në shërbim të studentit dhe e informojnë lidhur me datat e regjistrimet në provime, data e dorëzimit të temës së diplomës, për zhvillimin e mësimit dhe provimeve on line, njoftimet për punësim etj.<br>Për sa më sipër themi se studentët gjatë procesit të formimit duke filluar që në fazën e parë të regjistrimit dhe duke përfunduar me fazën e punësimit janë vazhdimisht të informuar dhe të përditësuar.<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | GVJ konstatoi se, institucioni I ZKM-së zotëron një system informimi dhe këshillimi, mjaft efikase duke fillura nga Zyra e Pranimit të Studentëve e cila ofron drejtpërdrejt dhe on line një shërbim informacioni, që u drejtohet të gjithë atyre që janë të interesuar të studiojnë në UZKM. Zyra e Pranimit ofron shërbim edhe nëpërmjet disa formave të tjera të ndërveprimit si: kontakt i drejtpërdrejtë me publikun në zyrën e pranimit, telefon, postë elektronike, media sociale dhe drejtpërdrejt në zyrat e Universitetit: ëëë.unizkm.al kushtuar pranimeve.<br>Duke vazhduar me Sekretarinë Mësimore ku student mundt'i drejtohet për të përfituar një sërë shërbimesh, si mëposhtë: Informacione për regjistrim në programin e studimit, dorësimin e kërkesës për diplomim etj.<br>Për sa i përket problematikave të tjera të lidhura me programin e studimit dhe procesin mësimor është figura e Koordiantorit.<br>*Evidenca nr.9. Statuti*<br>*Evidenca nr. 23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca nr 33. Rregullore e bibliotekës*<br>*Evidenca nr 43. Rregullore mbi veprimtarine e sekretarisë mësimore*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për | GVJ gjatë vlerësimit të RVB dhe vizitës në institucion një vend të rëndësishëm i kushtoi dhe takimit me zyrën e karrierës, ku konstatoi se institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Një zyrë tjetër që ndihmon në lidhje me organizimin mësimor, procedurat e diplomimit etj është edhe Sekretaria Mësimore, që jep informacion në lidhje me karrierën dhe rezultatet e studentit në lidhje me programin e studimit të tij. |

| | |
|---|---|
| praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Gjithashtu, në sekretarinë mësimore studentit i ofrohet ndihma e duhur në lidhje me organizimin mësimor, procedurat e diplomimit, njoftimet për çështje të ndryshme që lidhen me karrierën e tyre.<br>Një tjetër zyrë e cila është në mbështetje të kompletimit të procesit mësimor është edhe IT e cila ka krijuar sistemin ***UniMS*** që mban një bazë të dhënash në format elektronik për të dhënat personale të studentit, kontaktet, të dhënat e mësimdhënies.<br>Ky system është përshtatur me sistemin softëare për menaxhimin e universitetit, të quajtur UniMS (Sistemi i Menaxhimit të Universitetit). GVJ konstatoi gjatë vizitës se egsiton edhe rregjistri i studentëve ku ruhen informacionet personale, kontaktet, karriera mësimore, frekuentimi, provimet, notat etj.<br>*Evidenca nr. 23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca nr 33. Rregullore e bibliotekës*<br>*Evidenca nr 43. Rregullore mbi veprimtarine e sekretarisë mësimore*<br>*Evidenca nr 59. Rregullore e sekretarisë për rregjistrimin e studentëve dhe rregjistrin bazë.*<br>*Evidenca nr.60. Rregjistri i përgjithshëm i studentëve*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion dhe gjatë takimit me përfaqesuesen e zyrës se Këshillimit të Karrierës se kjo e fundit administron dhe menaxhon "Regjistrin e të Diplomuarve". Rregjistri përditësohet çdo vit me objektivin që të ndihmojë të diplomuarit për t'u ndërlidhur me kompani të profileve të ndryshme që i përshtaten profesionit të tyre, si edhe t'i informojë ata mbi evente të ndryshme të organizuara nga Universiteti në mënyrë që të mundesohet pjesëmarrja në to.<br>Përditësimi i të dhënave i "Regjistrit e të Diplomuarve", mundësohet përmes plotësimit të një pyetësori në google form https://docs.google.com/forms/d/1sPn6ëixSQ8UuK_sqm7UDiFiPk6VëA6et5bFklmeylmY/edit<br>*Evidenca nr.105 Raport mbi të diplomuarit në Fizioterapi*<br>*Vizitë në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Vlerësimi i cilësisë në Universitetin KZKM, sipas GVJ-së mendojmë se është konform Statutit, Rregullores se NJVBC dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.<br>Sipas RVB-së së përgatitur nga grupi i punës si dhe konstatimit që bëri GVJ në vizitën në institucion rezulton që IAL kryen këtë vlerësim në forma të ndryshme:<br>- nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve në mënyrë elektronike, të cilët zhvillohen para provimit të lëndës përkatëse<br>- takime me zyrat organizative, administrative, mësimore dhe kërkimore të Universitetit<br>*Evidenca nr.9.Statuti*<br>*Evidenca nr.12.Rregullore e Fakultetit*<br>*Evidenca nr.30 Perceptimi i studentëve kundrejt veprimtarisë mësimore*<br>*Evidenca nr.29/1;29/2 Modeli i Pyetësorit*<br>*Evidenca nr.62/1;62/2 Modeli i Pyetësorit*<br>*Evidenca nr.64. Rregullore mbi funksionet e Njësisë së Vlerësimit të cilësisë së brendëshme*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | UKZKM ka një Njësi të Vlerësimit të Brendshëm të cilësisë e cila përbëhet nga 5 anëtarë. Kjo njësi kontrollon paraqet Rektorit një raport vjetor mbi aktivitetin mësimor, kërkimore dhe mbi shërbimet e ofruara nga IAL-ja. Njëkohesisht është përgjegjëse për mbledhjen, menaxhimin, ruajtjen dhe komunikimin e mendimeve të studnetëve për mësimdhënien që është dhënë.<br>Për realizimin e funksioneve të saj Njësia bazohet në rregulloren e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit dhe ka të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentet, dhe informacionet e tjera të Universitetit dhe në të njëjtën kohë të ruajë konfidencialitetin e dokumenteve të mbledhura.<br>*Evidenca nr.63. Përbërja e Komisionit të Vlerësimit të Brendhshëm të Cilësisë*<br>*Evidenca nr. 64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Njësia e Sigurimit të Brendshëm për Vlerësimin e Cilësisë është e përbërë nga 5 anëtarë nga të cilët 3 janë përfaqësues të Universitetit, një përfaqësues i studentëve dhe një përfaqesues i jashtëm.<br>Ne konstatojmë se institucioni përdor në nivel operacional:<br>a) *pyetësorët tek studentët* për mbledhjen e të dhënave lidhur me aspekte të ndryshme të veprimtarisë mësimore e asaj administrative, në përputhje kjo me pikat 3 & 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015; |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | b) Takime formale dhe informale me studentët<br>c) kontaktim akademik dhe administrativ nëpërmjet e-maili për marrjen e informacioneve të domosdoshme<br><br>Në aspektin taktik, institucioni përdor:<br>a) *raportime tek drejtuesit;*<br>Sa i përket aspektit strategjik, NjSBVC ka gjeneruar informacion sasior dhe cilësor, për të ardhur në ndihmë GVJ në ndihmë të akreditimit të jashtëm, në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 në këtë aspekt.<br>*Evidenca nr.9.Statuti*<br>*Evidenca nr.12.Rregullore e Fakultetit*<br>*Evidenca 23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca nr.30 Perceptimi i studentëve kundrejt veprimtarisë mësimore*<br>*Evidenca 40 Formulari i ankimimit*<br>*Evidenca nr.29/1;29/2 Modeli i Pyetësorit*<br>*Evidenca nr.62/1;62/2 Modeli i Pyetësorit*<br>*Evidenca nr.63. Përbërja e Komisionit të Vlerësimit të Brendhshëm të Cilësisë*<br>*Evidenca 64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit*<br>*Vizite ne institucion* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | GVJ nisur nga RVB, vizita dhe takimet institucionale mendon se IAL-ja, ofron në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë një politikë të qartë.<br>Gjithashtu, synon krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.<br>Gjata takimeve rezultoi se fokusi kryesor i stafit akademik dhe drejtuesve janë elementet e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke specifikuar elementet përbërës të moduleve, krediteve, bazës së nevojshme didaktike për realizmin e programit teë studimit, literaturës së përdorur, procedurat e kontrollit të dijeve/provimeve dhe analizës së rezultateve të kontrollit.<br>*Evidenca nr.9.Statuti*<br>*Evidenca nr.12.Rregullore e Fakultetit*<br>*Evidenca 23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca 64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit*<br>*Vizitë në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi VI.2**
**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. | GVJ mendon se në UKZKM ekzistojnë dhe janë funksionale njësi specifike përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikqyerjen, rishikimin e programit të studimit.<br>Këto njësi nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të mekanizmave të procesit mësimor evidentojnë dhe përmirësojnë problematikat kryesore të lidhura me studentët dhe kurrikulën.<br>*Evidenca nr.63 Përbërja e Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë*<br>*Evidenca 64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. | GVJ bazuar në RVB konstaton se:<br>Në raportin e Zyrës së statistikës, që mbështet NjSBVC në funksionimin e saj, prezantohet pyetësori për studentët që, përmes pyetjeve që lidhet me programin e studimit në fjalë, adreson aspektin mbikqyrës që kërkon ky kriter, gjithashtu konstatoi se, nuk përmbahen të dhëna lidhur me mbikëqyrjen e këtij programi studimi, në vite lidhur me cilësin e këtij programi . Si pasojë duke mos disponuar raporte ndër vite të NjSBVC dhe Zyrës së statistikës, është e pamundur të konfirmohet karakteri i herëpashershëm i aktiviteteve shqyrtuese, miratuese dhe mbikëqyrëse në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri.<br>Po kështu GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se program i Fizioterapisë pëson ndryshime , bazuar në ndryshimet vjetore sipas udhëzimeve të MASR, për ndryshim të programit rreth 20% cdo vit, si duke e përshtatur dhe me programin e partnerëve në Romë, që është dhe bashkëpunimi.<br>*Evidenca 64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. | GVJ nga raportet e depozituara dhe të cituara në kriteret e mësipërme, ai i Zyrës së Statistikës detajon në njëfarë mase metodologjinë e përdorur për të mbledhë dhe analizuar përgjigjet e studentëve në pyetësorët respektivë.<br>Në raportin e NjSBVC janë përdorur indikatorë për performancën e studentëve në rang universiteti, përfshirë edhe ata në programin e studimit të fizioterapisë. Për shkak se mungojnë raportet ndër vite është e pamundur të konkludohet për stabilitetin e metodologjisë dhe aplikimin e saj rigoroz vit pas viti, sikurse e kërkojnë aktet rregullatore.<br>*Evidenca nr.30 Perceptimi i studentëve kundrejt veprimtarisë mësimore*<br>*Evidenca nr.62 Modeli i Pyetësorit* |
| **Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | GVJ konstatoi se, të gjitha të dhenat e grumubulluara dhe të shfrytëzuara për ndryshimet në funksion të rritjes së cilësisë ruhen dhe i paraqiten Rektorit dhe Senatit Akademik nga Njësia e Vlerësimit të brendshëm në një raport vjetor mbi veprimtaritë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, mbi shërbimet e kryera nga Universiteti.<br>Po ashtu, kjo njësi raporton në lidhje me rezultatet e shprehura nga studentët, si edhe mbi nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të |

| | |
|---|---|
| | arritur nga njësitë e ndryshme organizative. Në raportin e vet vjetor, nxjerr në dukje praktikat e mira dhe, nëpërmjet rekomandimeve dhe analizave të synuara (të tipit SËOT), i paraqet rektorit dhe Senatit rekomandimet për vitin akademik pasardhës.<br>*Evidenca nr.30 Bashkë lidhet Perceptimi i Studentëve*<br>*Evidenca nr.63 Përbërja e Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë.*<br>*Evidenca 64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. | GVJ duke ju referuar dokumentacionit bashkëlidhur në RVB po edhe gjatë takimeve me Zyrën e Statistikës dhe Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm të Cilesise ne UKZKM, në përputhje me Rregulloren e vet, kjo njësi përgatit nje raport vjetor lidhur me cilësinë e mësimdhënies të cilin ja paraqet Rektorit së bashku me rekomandimet e bëra.<br>Megjithatë ne sugjerojme që ky raport të jetë periodik ndër vite për tëpatur një matje më të mirë të cilësisë dhe përmiresimin akoma edhe me shumë të saj.<br>*Evidenca 64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit*<br>*Vizite ne institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | GVJ konstaton, bazuar dhe në RVB se institucioni e ka përfshirë këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit, po keshtu, institucioni bën vlerësimin e brendshëm të programit të studimit në mënyrë nga njësia e brendshëme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi.<br>Të dhënat e mbledhura përpunohen dhe çdo vit Bërthama e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë e Universitetit boton një raport në përputhje me ligjet në fuqi dhe me Statutin e Universitetit.<br>Ajo cka GVJ sugjeron është që Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të cilësisë të ngrihet në nivel Fakulteti, pasi aktualisht është në bazë universiteti.<br><br>*Evidenca 64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | GVJ u njoh me disa metoda, instrumente që përdor institucioni për vlerësimin e programit të Fizioterapisë dhe programeve të tjera dhe konstaton se metodat dhe instrumentet e përdorura janë bazike dhe të kënaqshme.<br>Disa nga keto metoda jane intervistat e strukturuara ose kërkesat për informacion (të shpërndara nëpërmjet postës elektronike) deri tek |

| | |
|---|---|
| | intervistat më jo formale në mënyrë që të sqarohen ose thellohen tema me interes më të madh. Një mënyrë tjetër për të marrë reagime, veçanërisht nga studentët, është nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta të mbajtura nga Koordinatori i program të studimit. Takimet me studentët janë të nevojshme për monitorimin në kohë reale nga ana e institucionit, e procesit të të nxënit, e vlerësimit të procesit të cilësisë së mësimdhënies dhe e personelit administrative. Gjithashtu mund të bëhen analiza edhe me të thelluara, përmes teknikave më të sofistikuara, për të nxjerrë konkluzione të dobishme.<br>*Evidenca 23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca nr.30 Perceptimi i studentëve kundrejt veprimtarisë mësimore*<br>*Evidenca nr.29,62 Modeli i Pyetësorit*<br>*Vizitë në institucion* |
| Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera. | GVJ në takimet e realizuara në institucion ashtu sic u përmend dhe në kreun I,2 përdor metoda të drejtpërdrejta (takime me studentët, intervista on-line etj).<br>Në këtë kuadër gjatë takimit me koordinatorin dhe Sekretarinë Mësimore rezulton se një ditë përpara diplomimit studentët e këtij programi studimi zhvillojnë provimin e shtetit në prani të përfaqësueseve të Ministrisë Italiane të Arsimit dhe të Urdhrit të fiziotertapistëve italian dhe shqiptarë për profesionet e rregulluara(provimi i licensës).<br>*Evidenca 23 Funksionet e Koordinatorit*<br>*Evidenca nr.30 Perceptimi i studentëve kundrejt veprimtarisë mësimore*<br>*Evidenca nr.29,62 Modeli i Pyetësorit*<br>*Evidenca nr 43. Rregullore mbi veprimtarine e sekretarisë mësimore*<br>*Vizitë në Institucion* |
| Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Siç se kemi theksuar edhe në kriteret e mësipërme IAL përdor pyetësor për shprehjen e mendimeve për stafin akademik dhe studentëve për sa i përket vlerësimit të dijeve dhe kompetencave të përfituara nga programi.<br>Gjithashtu ndihmon edhe Alumni<br>https://ëëë.unizkm.al/posts/slug/alumni-reunion-2019<br>*Evidenca nr.30 Perceptimi i studentëve kundrejt veprimtarisë mësimore*<br>*Evidenca nr.29,62 Modeli i Pyetësorit*<br>*Evidenca nr 43. Rregullore mbi veprimtarine e sekretarisë mësimore*<br>*Vizitë në Institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | GVJ bazuar në RVB, në ligjin 80/2015 neni 103, VKM 531 dt 11.9.2018 (Kodi i Cilësisë) Statutin instiucional si dhe duke referuar rregullores së NJBSVC konstatohet se është ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në bazë universiteti dhe janë parashikuar rregullat e procedurat për funksionimin e saj. Në përbërje të NJBSVC është përfshirë një ekspert i jashtëm dhe 4 të brendshëm: 1 student dhe 3 staf akademik.<br>Për sa më sipër sugjerojmë se ky grup të ngrihet në nivel Fakulteti dhe jo Universiteti.<br>*Evidenca nr 63 Përbërja e Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë.*<br>*Evidenca 64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Rregullorja e NJSBVC parashtron detyrat për strukturat e përfshira në garantimin e brendshëm të cilësisë. Rregullat e parshikuara janë të qarta bazuar dhe në rregulloren e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit<br>Sugjerojme që raportet lidhur me vlerësimin e cilësisë të jenë periodik për cdo vit akademik.<br>*Evidenca 64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. | GVJ bazuar në RVB si dhe informacioneve të marra gjatë takimit vuri re se, në procesin e vlerësimit dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor Fizioterapi janë të përfshirë anëtarët e njësisë bazë dhe të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.<br><br>*Evidenca nr.30 Perceptimi i studentëve kundrejt veprimtarisë mësimore*<br>*Evidenca nr.64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit*<br>*Vizitë në institucion* |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Nga takimet me studentët, pedagogët sikurse edhe me përfaqësues të NJSBC nuk u konstatuan ankesa apo raportime në këtë drejtim.<br>Njëkohësisht nga baza dokumentare dhe RVB nuk konstatohen elemente që të krijojnë dyshime për trajtim diskriminues në përfshirjen e dhe aktivizimin sa i përket proceseve vlerësuese. Pyetësorët deklarohen nga koordinatori se janë anonim dhe në raportin e NJBSVC del se në Zyrën e Statistikës nuk përmbahen emra me kontekst denigrues, fyes apo diskriminues, në respektim të Kodit të Etikës.<br>*Evidenca 23 Funksionet e Koordinatorit*<br><br>*Evidenca nr.30 Perceptimi i studentëve kundrejt veprimtarisë mësimore*<br>*Evidenca nr.64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit* |

| Kriteri | Vlerësimi |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Institucioni organizon procedura për krahasimin dhe përfshirjen midis aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit dhe të pranishëm në territor. Ekspertët e jashtëm të cilët përfshihen në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit. Në përfundim, të gjithë aktorët e Programit të Studimit të Bachelor në Fizioterapi, personeli teknik administrative dhe pedagogët, janë të përfshirë dhe përgjegjës në proceset e ndryshme të menaxhimit dhe zhvillimit të programit të studimit nëpërmjet konsultimeve, takimeve periodike.<br>Përvec vlerësimit të brendshëm, element tjeter i sigurimit te cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL. Ky vlerësim kryhet nëpërmejt hartimit të raporteveë të vlerësimit, ku pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësimin dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë.<br>*Evidenca 23 Funksionet e Koordinatorit*<br><br>*Evidenca nr.64 Rregullore e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit*<br>*Evidenca nr.63 Përbërja e Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë*<br>*Vizitë në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi VI.5**
**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | GVJ nga takimi me Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm dhe Zyrën e Statistikave konsatoi, se UKZKM për sigurimin e cilësisë së brendëshme në mënyrë të vazhdueshme aplikon pyetësorë anonim në formë elektronike me studentët para sezonit të provimeve. Studentët shprehin mendimin e tyre pa u u ndikuar nga stafi mbi: mësimdhënien, etikën pedagogjike, infrastrukturën, paisjen e laboratorëve, mënyrën e vlerësimit, mendime për lëndët/ modulet përsa I përket raportit lexion/seminar/laborator/praktik, literaturën e vënë në dispozicion etj. Informacioni i mbledhur nxjerr në pah problematikat e ndryshme që mund të ketë dhe nga zyra e Statistikave bën përpunim statistikor, nxjerr rekomandime të shoqëruara me një analizë përmbledhëse SWOT. Problematikat e dala ju bëhen me dije dhe janë transparente edhe për stafin akademik dhe për studentët.<br>Këto rekomandime vlejnë dhe janë shumë të rëndësishme për autoritetet vendimmarrëse të Universitetit, në mënyrë që ato të arrijnë të marrin masat e nevojshme në kohë reale për përmirësimin e problematikave të dala.<br>Po kështu NJVCB të UKZKM këtë raport vjetor në dispozicion të Rektoratit dhe Senatit dy organet më të rëndësishme vendimmarrëse.<br>*Evidenca nr.63 Përbërja e Komisionit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr.64 Rregullorja e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë* |
| **Kriteri 2.** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | GVJ konstatoi sic e kemi përmendur dhe në *Kriterin 1 të standartit VI.5 kriteri 1* , se bazuar në rregulloren e funksionimit të njësisë së vlerësimit të cilësisë, ka transparencë në mbledhjen, publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale, ashtu sic janë të përpiluara dhe në këtë rregullore<br>*Evidenca nr.64 Rregullorja e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | GVJ konstatoi bazuar në RVB, si dhe evidncat përkatëse se Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë merret me mbledhjen, menaxhimin dhe ruajtjen, komunikimin e studentëve për mësimdhënien, këto të dhëna i ruan ne formë shkresore dhe elektronike. Gjithë ky informacion shërben dhe synojnë përmirësimin e mangësive apo dobësive të evidentuara në këtë program studimi.<br>*Evidenca nr.64 Rregullorja e funksioneve të Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Po kështu GVJ vuri re se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive të realizuara nga njësia bazë, koordinatori gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë, e cila ndikon në përmirësimin në vijim të cilësisë së programeve të studimit në përgjithësi dhe programit të studimit bachelor në Fizioterapisë në vecanti.<br>*Evidenca nr 23 Funksionet e Koordinatorit* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Gjatë takimit me stafin akademik, studentët, GVJ konstatoi se institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit jo vetëm të Diplomës Fizioterapi, por për të gjitha programet e studimit që mbulon UZKM.<br>*Vizitë në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Fizioterapi" të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të mirë"**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Studentët e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "FIZIOTERAPI " të cilët mbarojnë në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" zotërojnë një diplomë europiane të njohur jo vetëm në Shqipëri, por edhe në në vendet anëtare të Bashkimit Europian.
2. UKZKM falë bashkëpunimit me Universitetin e Tor Vergata të Romës , ofron një cilësi arsimi dhe standardeve të nivelit të Bashkimit Europian.
3. Marrëveshjet e bashkëpunimit me Universitetin Tor Vergata të Romës për realizimin e praktikave profesionale në Itali, krijojnë lehtësira për realizimin e programit të studimit në mënyrë cilësore.
4. Prania në infrastrukturën e UKZKM-së e një qendre të Rehabilitimit të Mjekesisë Sportive e pajisur me aparatura moderne si dhe një pishine përbën një pikë të fortë për realizimin e praktikës klinike.
5. Prania në stafin akademik edhe e pedagogëve me përvojë akademike europiane të Universitetit Tor Vergata të Romës, rrit cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë institucion.
6. GVJ mendon se një pikë tjetër e fortë për UZKM, është dhe prania e një infrastrukturë moderne mësimore, laboratorike, kabinete, ngritja e spitalit etj.
7. Prania e zyrës së karrierës është një pikë tjetër e fortë e UZKM e cila mban korespodencën me studentët e diplomuar në UZKM dhe ndjek dhe orienton ata në tregun e punës.
8. Prania e një biblioteka fizike dhe on line me një larmi literature e cila vihet në dispozicion të studentëve me orar të zgjatur gjatë gjithë vitit akademik me përjashtim të festave fetare.
9. Realizimi i procesit mësimor në gjuhë të huaj (italisht) përbën avantazh për studentet që dëshirojnë të ndjekin formimet e mëtejshme në Master Shkencor apo Doktoraturë. Gjuha italishte është një nga pesë gjuhët e huaja sipas udhëzimit nr 52 datë 3.12.2015 të MASR, si kriter hyres per studimet e ciklit të dytë dhe të tretë.

**Pikat e Dobëta:**

1. Nivel i ulët i kërkimeve shkencore, për shkak të mungeses së fondeve të alokuara nga UKZKM për to.

2. Numer i ulët i institucioneve të huaja të kontraktuara për zhvillimin e praktikave mësimore. Duke qenë një institucion që lëshon diploma europiane, numri i qendrave të zhvillimit të praktikave mësimore gjykojmë të jetë më i lartë në shtetet e huaja.

**Rekomandime:**

1. GVJ rekomandon mundësisht unifikimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "FIZIOTERAPI" me programin e të njëjtit nivel të institucioneve shtetërore, pasi programet e ndryshme vështirësojnë procesin e transferimit të studimeve, nga njëri fakultet te tjetri, kur ato kërkohen nga studentët. Si psh (Anatomia Normale te programi i Fizioterapisë në UZKM është 3 kredite, ndërsa në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike 9 kredite), gjithmon ndryshimi në përputhje me udhëzimet e MASR dhe kontratave të bashkëpunimit me Universitetin e Tor Vergata të Romës.

2. GVJ rekomandon që të shtohen fondet dhe te alokohen zhvillimin e e puenëve kërkimore si për studentët ashtu edhe për profesorët.

3. GVJ rekomandon që të shtohen institucionet e huaja për zhvillimin e praktikës, duke pasur parasysh edhe natyrën e programit dhe faktin që studentët pajisen me diplomë europiane.

4. GVJ rekomandon që mësimi krahas gjuhës italiane që zhvillohet aktualisht, mundësisht mësimi të zhvillohet në gjuhën angleze, pasi anglishtja mjekësore, mendojmë do ta lehtësojë më shumë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies te studentët e Fizioterapisë.

5. GVJ sugjeron që institucioni të ketë një raport periodik për cdo vit akademik për të patur një vlerësim më të mirë të cilësisë mësimdhënies dhe për të parë ndryshimet në vite.

6. GVJ sugjeron që Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë të ngrihet në nivel Fakulteti, pasi mendojme do të ndihmoj më shumë në Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë.

## Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in "Physiotherapy" of the Institution of Higher Education Catholic University "Our Lady of Good Counsel"

**Strengths and affirmations:**

1. The Students who graduate in the study program from the Catholic University "Lady of Good Counsel" hold an European degree recognized not only in Albania but also in the member states of the European Union.

2. CUOLGC thanks to the cooperation with the University of Tor Vergata of Rome, offers a quality education and European Union level standards.

3. Cooperation agreements with the Tor Tor Vergata University of Rome for the realization of professional internships in Italy, create facilities for the realization of the

study program in a qualitative way.

4. The presence of a Rehabilitation center of Sports Medicine in the CUOLGC, equipped with modern equipment as well as a swimming pool constitutes a strong point for the realization of clinical practice.

5. The presence in the academic staff of professors with European academic experience of Tor Vergata University of Rome, increases the quality of teaching and learning in this institution.

6. EEG thinks that another strong point of CUOLGC, is the presence of a modern teaching infrastructure, laboratory, cabinets, establishment of a hospital, etc.

7. The presence of the career office is another strong point of CUOLGC which maintains the correspondence with the graduate students, follows and guides them in the labor market.

8. The Presence of a physical and on-line library with a variety of literature which is made available to full-time students throughout the academic year with the exception of religious holidays.

9. The realization of the teaching process in a foreign language (Italian) is an advantage for students who want to pursue further training in Master of Science or Doctorate. Italian is one of the five foreign languages according to the instruction no. 52 dated 3.12.2015 of MASR, as an entry criterion for the second and third cycle studies.

**Weaknesses:**

1. Low level of scientific research, due to lack of funds allocated by CUOLGC.

2. Low number of foreign institutions contracted for the development of teaching practices. Being an institution that issues European diplomas, the number of centers for the development of teaching practices we judge to be higher in foreign countries.

**Recommendations:**

1. GVJ recommends possibly the unification of the first cycle study program Bachelor "Physiotherapy" the same level state institutions programs, as different programs complicate the process of transferring studies from one faculty to another, when they are required by students. For example (Normal Anatomy in the Physiotherapy program at UZKM is 3 credits, while in the Faculty of Medical Technical Sciences 9 credits), always the change in accordance with the instructions of MASR and cooperation contracts with the University of Tor Vergata of Rome.

2. EEG recommends that funds be increased and that the development of research work be allocated to both students and professors.

3. EEG recommends that more foreign institutions be added for the development of

internships, taking into account the nature of the program and the fact that students are provided with European degrees.

4. EEG recommends that teaching in addition to the Italian language that is currently taking place, preferably teaching in English, as medical English, we think will facilitate the process of teaching and learning to physiotherapy students.

5. EEG suggests that the institution have a periodic report for each academic year to have a better assessment of the quality of teaching and to see changes over the years.

6. EEG suggests that the Internal Quality Assessment Unit be raised to the Faculty level, as we think it will help more in the Internal Quality Assessment

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |